

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 263, Shtator 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Viti 2025, 100-vjetorit të lindjes së Albanologut Martin Camaj "Nderi i Kombit" dhe "Qytetar Nderi" i qytetit të Shkodrës

### Plisi i Bardhë, në rrugëtim për në UNESCO 2

Në Krujë, më 31. 08. 2025, nënshkruhet nga shumë shoqata ardhur nga mbarë trojet etnikë shqiptare, një kërkesë – referendare, që Plisi i Bardhë të regjistrohet në UNESCO. Edhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini" një mbështetëse referendare, në nismën nga Shoqata "Bytyçi", që Plisi i Bardhë të regjistrohet në UNESCO, si element i trashëgimisë etno-kulturore të Kombit Shqiptarë. Kjo arritje është vepër e Misionaret Plisbardhë, të cilët para vetes kanë shtruar veçse objektiva patriotikë, për lartësimin e kombit shqiptarë. Me nismën dhe përgatitjet e Shoqatës Mbarëkombëtare "Bytyçi", Tiranë-Prizren, nga qyteti historik i Krujës, më 31.08. 2025, PlisBardhi e mori rrugën për në UNESCO, kjo kërkesa-referendare e mbështetur masivisht nga shumë shoqata simotra nga të gjitha trojet etnikë shqiptare të Gadishullit ILIRIK, që Plisi i Bardhë të regjistrohet në UNESCO, si pasuri Botërore, e cila i përket kombit shqiptar.

### Përkujtim me nderime për kapiten Eduard Kreuzig dhe ushtarët austro-hungarezë në Shkodër 5

Në Shkodër u zhvillua një ceremoni përkujtimore në nder të kapitenit Eduard Kreuzig dhe dhjetëra ushtarëve të tjerë të ushtrisë austro-hungareze, të cilët prehen në këtë qytet pa u përmendur emër për emër gjatë Luftës së Parë Botërore.

Veprimtaria u organizua me rastin e vizitës së Presidentit të përfaqësuesit të Vjenës të Kryqit të Zi Austriak, z. Claus Heitz, dhe mbledhi së bashku përfaqësues të lartë të Ambasadës Austriake, Ambasadës Çeke, Komandantin Robin Kalina, përfaqësues të Ambasadës Hungareze, ekspertin e integritit z. Erik Haupt me familje, Konsullin e Nderit të Austrisë në Shkodër z. Gjergj Leqejza, si dhe personalitete të tjera ushtarake si kolonelët në pension Flamur Muça dhe Ndue Sanaj. Të pranishëm ishin gjithashtu përfaqësuesi i Kryqit të Zi Austriak në Shqipëri, z. Florian Doschek, organizata të shoqërisë civile si Malteser dhe Paqe dhe Drejtësi, drejtuesi ...



### Mbresa nga Takimi Kombëtarë i Lahutarëve - 2025 6

("Shpella e Frashnit", Bajzë, Malësi e Madhe)

Të shpalosësh në një veprimtari të tillë gjithë arsenalin etnokulturës të një treve apo të mbarëkombëtar, është e pamundur, por e rëndësishmja qëndron tek ajo që brenda mundësive e kohështirjes arrin të lësh gjurmë dhe të përçosh "mesazhe" tek bashkësia e brezat e sotëm e të nesërm, se ne i kemi vlerat, kemi potencialet e ja tek janë në formë e në përmbajtje për ti shpalosur me gjithë shpirtë e zëmër e patjetër edhe me profesionalizëm.

# Plisi i Bardhë, në rrugëtim për në UNESCO

Në Krujë, më 31. 08. 2025, nënshkruhet nga shumë shoqata ardhur nga mbarë trojet etnikë shqiptare, një kërkesë – referendare, që Plisi i Bardhë të regjistrohet në UNESCO. Edhe Shoqata Atdhetare “Dukagjini” një mbështetëse referendare, në nismën nga Shoqata “Bytyçi”, që Plisi i Bardhë të regjistrohet në UNESCO, si element i trashëgimisë etno-kulturore të Kombit Shqiptarë. Kjo arritje është veper e Misionaret Plisbardashë, të cilët para vetes kanë shtruar veçse objektiva patriotike, për lartësimin e kombit shqiptarë. Me nismën dhe përgatitjet e Shoqatës Mbarëkombëtare “Bytyçi”, Tiranë-Prizren, nga qyteti historik i Krujës, më 31.08. 2025, PlisBardhi e mori rrugën për në UNESCO, kjo kërkesa-referendare e mbështetur masivisht nga shumë shoqata simotra nga të gjitha trojet etnikë shqiptare të Gadishullit ILIRIK, që Plisi i Bardhë të regjistrohet në UNESCO, si pasuri Botërore, e cila i përket kombit shqiptar. Është hera e parë, që nga një gjeografi kaq e gjerë e Gadishullit ILIRIK, bashkohen kaq shumë shoqata numri i të cilave si mbështetëse e nënshkruese, afrohet në 100, të cilat në një mendje, pa dilemë dhe ekuivok, e kanë mbështetur iniciativën e shoqatës “Bytyçi”, për ta nënshkruar një kërkesë referendare, drejtuar institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, qe: Plisi I bardhë dhe kostumi i tij kombëtar, të regjistrohen dhe të merren në ruajtje si vlera të trashëgimisë etno-kulturore, materiale dhe shpirtërore e Kombit Shqiptarë, dhe ato me atë identitet të regjistrohen edhe si vlerë dhe pasuri Botërore, ngase Plisi mbart rendësi kombëtare dhe për historinë botërore. Ajo, që u arrit dhe u krye si një akt i shkruar dhe nënshkruar me një dekoruesi aq të gjerë, është një arritje mbarëkombëtare, ndonëse u realizua atë ditë, ishte veçse moment i maturimit të një procesi të gjatë dhe të mundimshëm. Për te arritur ne atë pikë, është menduar dhe stërmunduar, studiuar, programuar dhe realizuar përmes një procesi të gjatë organizimesh e veprimtarish, fillimisht me qëllim të aktualizimit e masivizimit të përdorimit të Plisit të Bardhë. Në kryeqendrën historike të kombit shqiptarë, në qytetin dhe kështjellën e Krujës e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, u finalizua përmes një kërkesë - referendumi, për tu regjistruar dhe ruajtur si vlerë e çmuar simboli ynë i lashtë, Plisi i Bardhë dhe kostumi i tij kombëtar, por asaj ditë të shënuar i kanë paraprirë shumë ditë të tjera. Ai proces ka filluar shumë vite më parë punë, për aktualizimin e përdorimit dhe të studimit të simbolit tonë të lashtë, Plisit të Bardhë, i cili nuk ka reshtur si i tillë në Shqipëri, ku është themeluar edhe Festa e Plisit të Bardhë, si një nismë për tu shpallur festë mbarëkombëtare, duke kaluar dekadat e mbajtjes se sajë. Por këto nisma janë përhapur nga misionaret plisbardashë edhe në Kosovë, Maqedonin

e Veriut, Luginën e Preshevës, Malin e Zi dhe mërgatën shqiptare, duke e shpëtuuar simbolin tonë të lashtë nga harresa e “vdekja e tij klinike”, për të vijuar si i tillë. Ka qenë një moment që e prisnim,

si, një vlerë dhe punë gjurmëlënëse, duke ja nisur fillimisht me Plisin e Bardhë, si simboli unik dhe unifikues i shqepëtave, ndonëse si një pikënisje e merituar, misionaret plisbardashë nuk do të mjaftohen

kombëtarë. Në këtë kuadër diskutimesh, duhet theksuar se fqinjët tanë, jo pa rezultat janë përpjekur dhe po përpiqen që të shumëfishojnë territoret e tyre në kurrizin tonë. Janë përpjekur dhe po përpiqen që të asimilojnë me të pavendosurit në mesin tonë. Janë përpjekur dhe po përpiqen që të komprometojnë më të pavetëdijshmit dhe të dobëtit... Janë përpjekur duke ja arritur dhe po përpiqen të përvetësojnë vlerat dhe trashëgimin tonë. Kurse ne ende nuk jemi ndërgjegjësuar e unifikuar kolektivisht, që të rezistojmë e të luftojmë për atë që është vlerë e jona, të cilat duhet ti vlerësojmë dhe jo të mos i vlerësojmë. Vetëm atëherë kur gjithsecili prej nesh, do ti bëjë pyetjen vetës, se çfarë na ka gjetur me këtë patologji medie dhe deri kur do të vijojmë kështu, jemi përpjekur dhe do përpiqemi, që të mos prekemi nga ana e saj, dhe po ashtu jemi përpjekur dhe do të përpiqemi për parandalimin dhe kurimin e saj në shoqërinë tonë të sëmurë si asnjëherë tjetër përballë vetëdijes tonë. I kemi kontribuar dhe do ti kontribuojmë funksionimit sa më mirë e konkretizimit praktik të parimit moral e kombëtar, se: “Pa bashkuar kokat nuk bashkohen tokat”, si e tillë aleatin shpirtërorë kryesor e kemi gjetur dhe po i dedikohemi. Në atë ditë të mbështetur nga shumë shoqata simotra nga vendi dhe Trojet etnikë të Gadishullit ILIRIK, në Kështjellën e Krujës, u nënshkrua kërkesa referendume drejtuar institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, që Plisi i Bardhë dhe uniforma e tij kombëtare, të regjistrohen si vlera të trashëgimisë kombëtare dhe asaj Botërore. Ndërsa “Festa e Plisit të Bardhë”, e cila nga ky takim do quhet “Festa e Plisbardashëve”, të shpallet festë mbarëkombëtare.


\*\*\*

Ky akt nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, është nënshkruar nga N/Kryetari i saj, z. Kole Çardaku. Ndërsa nga Shoqata Kulturore “Besa Shoshi”, është nënshkruar nga udhëheqësi artistik i saj, rapsodi Gjon Kosteri.



duke kontribuar, për rikthimin e përdorimit të Plisit të Bardhë në kushtet aktuale, thuajse në të gjitha trojet etnikë shqiptare, ashtu sikurse është përdorur edhe nga paraardhësit tanë, për ta kurorëzuar aktualizimin e tij, edhe duke e marrë në ruajtje dhe trashëgimin, nga shteti shqiptar, shteti i Kosovës, por duke e kërkuar edhe në shtetet e tjera ku shqiptaret janë shtet formues, e paralelisht regjistrimin e tij në UNESCO. Është edhe vetë Plisi i Bardhë, ai simbol i lashtë shqiptar sa vetë kombi, i cili ka imponuar shpirtërisht, si forcë magjike e mbajtjes dhe mbartjes së vlerave të arrira njerëzore, dhe na ka bërë të dallohem nga të tjerët. Prandaj ky simbol i yni i lashtë, të cilit ju kemi përkushtuar, është gjetur nga ana jonë si një “thember e Akilit” ku duhet goditur për të ndikuar thellësisht, apo si një “pikë mbështetje e levës së Arkimit”, për ti zhvendosur pikëpamjet tona në anën e unitetit dhe unifikimit kombëtar shqiptarë. Prandaj

në maratonën dhe misionin e tyre për rivlerësimin praktik të vlerave tona kombëtare, kjo do jetë vetëm si pikënisja e strategjisë së unifikimit dhe bashkimit Kombëtar Shqiptarë. Në 20 vite angazhim dhe veprimtari të shumta, lokale, regjionale, shqiptarë dhe mbarëkombëtare, Shoqata Mbarëkombëtare “Bytyçi”, Tiranë – Prizren, ka qenë dhe do jetë një “Misionarja Plisbardashë” e pandalshme e universal për sa i përket forcimit të identitetit kombëtar. Ai mision universal, përveç tjerash do të bëhet përmes forcimit të identitetit, unitetit, bashkëpunimit e bashkimit, një proces i pandalshëm dhe përditësisht veprues e vetëveprues. Ky mision i plisbardashëve, që kur ka filluar e do të vijojnë me “kurimin” e patologjisë mentale, që, së pari, ka pllakosur mendjet e cekta të politikave dhe për pasoj ka marrë shtrirjeje në bazë, për sa i përket qëndrimin përballë rritjes së vetëdijes kombëtare, dhe forcimit të identitetit tonë



# Fjala e plote e hapjes së Kryetarit të Shoqatës Mbarëkombëtare “Bytyçi”, Tiranë-Prizren, organizatorit të kësaj veprimtarie

Mbajtur, më 31.08.2025, në hapjen e manifestimit mbarëkombëtar, “Dita e Plisbardhëve” në Kështjellën e Krujës, më pjesëmarrje nga të gjitha trevat e Gadishullit ILIRIK

Të nderuar pjesëmarrës!

Vëllezër e motra nga të gjitha viset etnike të Gadishullit ILIRIK!

Nderim dhe respekt për të gjithat shoqata simotra nga të gjitha trojet etnike shqiptare!

Në emrin e Shoqatës Mbarëkombëtare “Bytyçi”, u përshëndesim dhe u urojmë mirëseardhjen!

Ju përgëzoj për përkrahjen dhe gatishmërinë tuaj, që të bëhemi së toku, pra së bashku, duke qenë në një mendje, për ta kryer një akt nënshkrimi të një dokumenti, me vlera kombëtare.

U vlerësojmë maksimalisht për sakrificat që keni bërë që të jemi sot së bashku, për ta lënë një gjurmë të përbashkët e të pashlyeshme në kahen e përbashkimit.

E them para jush më shpirt, se gatishmëria juaj për ta kryer këtë akt të përbashkët nënshkrimi, më ka emocionuar, më ka mrekulluar, por edhe më ka frymëzuar për rolin që po marrim çdo ditë e më shumë, si Misionarë Plisbardhë.

Pjesëmarrja juaj plebishitare edhe më ka lumturuar, por dhe po na tregon se, shqiptarët jo vetëm që kanë ditur, por edhe dinë të merren vesh në mes veti, për çështje kryesore e vlera kombëtare, ngase atdheun e kombin tonë i kemi të gjithë njësoj.

Jo pa qellim sot është Kruja e Gjergj Kastriotit, që na ka bashkuar, sepse na thërret amaneti i të parëve, se:

\*Duhet të behët ky komb si në kohën e lavdisë së tij më të madhe.

\*Jo pa qëllim është përcaktuar simbolika, sot është “Plisi i Bardhë” ai që na ka bërë në një mendje për të nënshkruar një akt, i cili duket i thjeshtë, por jo!

\*Sepse vlerat e këtij akti do të duken edhe në të ardhmen.

Edhe tani, nënshkrimi i këtij akti është një test i veçantë patriotik për ne.

Sot në këtë ditë, ka një rendësi të veçantë fakti se si rrallë herë tjetër më parë, jemi të bashkuar kaq shumë shoqata jo vetëm nga Shqipëria, por edhe Kosova, Maqedonia e Veriut, Sanxhaku shqiptar i Malit të Zi dhe Serbisë, Mali i Zi, Çamëria dhe Mërgata Shqiptare në botë.

Në këtë ditë më shumë se sa çdo herë



tjetër, merr kuptim për ne, shprehja se: “Pa i bashkuar kokat nuk i bashkojmë dot tokat!”

Do jetë Plisi i Bardhë Pellazgo-Ilir, Arbëroro - Shqiptar, i cili si një simbol i lashtë shqiptar, është pa përkatësi fetare e politike, apo çfarëdo tjetër përkatësie, dhe është ai i cili më mirë se çdo gjë tjetër, po bashkon dhe unifikon nën veten e tij, kokat e shqiptarëve.

Edhe ky rast si një tregues, sikurse është rendja për ta regjistruar Plisin e Bardhë dhe Kostumin e tij Kombëtar, si vlerë të trashëgimisë tonë materiale e shpirtërore, fillimisht së paku në Shqipëri dhe Kosovë, nga se deri tani në mënyrë të pafalshme jemi të vonuar.

Por ky nuk do jetë objektivi parësor,

sepse objektivi primar, është për ta regjistruar pa humbur kohë, Plisin e Bardhë e kostumin e tij kombëtare, në UNESCO.

Si një vlerë të trashëgimisë tonë etno-kulturale, materiale e shpirtërore të popullit shqiptar, sepse neglizhencat tona, bën që të tjerët po na i përvetësojnë vlerat tona.

Do të jetë edhe “forca mistikë” e Plisit të Bardhë, që merr të lidhur në mënyrë korrel-

këtë Gadishull.

Kjo ka ndodhur, po ndodh e nuk duhet që të ndodhë, sepse atëherë kur të jemi shumë vonë, nuk ka për të na u falë çdo gabim historik, sikurse mundet të jetë edhe vonesat me Plisin e Bardhë.

Është për ta theksuar se patriotet e vërtet të kohës së paqes, janë të gjithë ata që luftojnë për t'i ruajtur dhe pasuruar vlerat e trashëgimisë tonë në tërësi por edhe etno-kulturës tonë të pasur në veçanti.

Duhet vlerësuar mirë së është edhe etno-kultura që flet qartë për historinë e popullit tonë dhe lashtësinë e tij në këto troje. Aksioni i nënshkrimeve e njëherit edhe i unifikimit të mendimeve dhe qëndrimeve për këtë çështje, që sapo ka filluar procedurat e saj për regjistrim, është një impakt pozitiv, për të vijuar nënshkrimet më intelektual të ndryshëm, si dhe popullin e thjeshtë, duke i ngritur qendrat e nënshkrimeve në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Podgoricë, Novi-Pazar, Preshevë dhe Filat.

Aksionin e nënshkrimit në fjalë, dhe të disa sipërmarrjeve të tjera që lidhen me Plisin e bardhë, do t'i udhëheqin “Komiteti nacional i Plis-Bardhëve” për të cilin deklaroj sot se është ngritur grupi iniciator i regjistrimit të tij në Gjykatën e Tiranës. Në atë komitet do të bëjnë pjesë të gjithë Misionarët Plisbardhë, të cilët do të betohen mbi Plisin e Bardhë, të vendosur si bazament të tij, një pas një, mbi Flamur, gur e kanun.

Pas kësaj sipërmarrje, uroj që për akcione të tjera më rëndësi kombëtare, u bashkoshim këtu e në çdo kënd të trojeve etnike shqiptare të Gadishullit ILIRIK.

Ju faleminderit për angazhimin dhe kontributin Tuaj!

Ju faleminderit për vëmendjen!

Për të mira dhe interesa kombëtare u bashkoshim çdo herë!

Kryetari i Shoqatës Mbarëkombëtare  
“Bytyçi”, Tiranë-Prizren  
**AGRON ISA GJADIA**

\*\*\*

**Varianti i formulës së Betimit, për të cilin presim mendime:**

Betimi i Misionarit Plisbardhë

Betohem mbi këtë Plis të Bardhë, të cilin të parët tanë e kanë mbajtur të papërlëyer.

E na ka dhënë dhe na jep nderë e lavdi,

E pasha atë që na e ka dhënë shpirtin e frymëzues në këto troje qyshe se ka mbirë lisi, kemi marrë formën e kombit dhe fisit, se do të kontribuoj pa u nënshtruar e dorëzuar:

-Për ruajtjen e nderit ton të përbashkët,

-Të gjakut ton të pastës dhe gjuhës tonë pa “ferra”,

-Për kthimin e vëllezërve tanë të gjenit në identitet, të atyre që jo për fajin e tyre e kanë humbur atë.

-Së bashku, në unitet, të ruajmë dhe forcojmë identitetin ton kombëtar,

-Duke ruajtur trashëgimin ton më të mirë,

-Duke e ruajtur dhe bërë atë çdo herë

konkurruese vlerash,

-Por edhe vlerë të trashëgimisë më të mirë të kombeve të tjera.

-Betohem mbi këtë Plis të Bardhë

-Që rrinë qetë mbi këtë gurë të këtij trualli e e kanun e Flamur të Gjergj Kastriotit.

Betohem!

Mbi të e përmes tij, betimi është mbi gjerat më substanciale të kombit shqiptarë.

Në këtë formulë betimi, janë të përmbledhur elementet më bazikë, shprehëse dhe përgjithësuese, në të cilët ka besuar populli ynë, duke ndikuar në formësimin e personalitetit dhe të karakterit të tij.

Është vet Plisi i Bardhë, për nga ana spirituale, simboli më përfaqësues e vlera polivalentë, si një “pjesë” gjysmëvezën kozmike” nga ka ardhur jeta frymorë e njeriut. formën si kupë qielli përmes të cilit interferohet shpirtërisht me universin, ngjyrën e bardhë si dritën e diellit, përmes të cilës pasqyrohet pastërtia e shpirtit dhe karakterit. Si dhe nga

ana materiale si përfaqësues i etno-kulturës, petku unik e I papërsëritshëm, i cili ka marr formën e duhur pa pas asnjë qepje, por edhe pa kaluar në tezgjah, e të tjera.

Është shkamë - Guri - karshi, pjesa me konstitucionale e tokës, nga i cili është formuar dhe i korës së tokës e për shqiptarin, në mënyrë lakonikë dhe përmbajtjesore, është materializuar në shprehjen tradicionale se: “guri I rendë peshon në vendin e vet”,

Nënkuptimi është se gjithkund në trojet etnike shqiptarë, të cilat I “popullojnë” sot e kësaj ditë varret e të parëve tanë, edhe atje ku janë të shpërngulur me forcë, se vendi i të parëve të tyre, është i panegociushëm dhe i patjetërsueshëm, në të cilin vetëm aty do të bëjnë rahat.

Është lisi, i cila tradicionalisht është marrë e mitikisht, merret si momenti i lindjes së jetës bimorë mbi tokë, dhe thuhet sot e kësaj ditë, në mënyrë lakonikë dhe përmbajtjesore, është materializuar në shprehjen

tradicionale se: “qyshe se ka mbirë lisi”.

Geni, i cili në mënyrë lakonikë dhe përmbajtjesore, është materializuar në shprehjen tradicionale se: “gjaku që nuk bëhet ujë”.

Gjuha jonë e lashtë, që njihet edhe si mëmë e shumë gjuhëve të tjera, si elementi më bazik i identifikimit kombëtar dhe quhet: “Gjuha e nenës”.

Kanuni, i cili tregon për lashtësinë e organizimit shoqërorë, dhe flet për jetën tonë të normuar dhe organizuar me rregulla të përcaktuara qartë, drejtë e shoqërisht shumë funksional, që në lashtësi, me një drejtësi thuajse si hyjnore, e cili në mënyrë lakonikë dhe përmbajtjesore, është materializuar në shprehjen tradicionale se: “Atë që donë të ja bësh tjetrit, së pari ktheje dhe matë për vetë a të shkon përshtatshëm!”

Shoqata Mbarëkombëtare  
“Bytyçi”, Tiranë-Prizren  
**Kryetari - AGRON ISA GJEDIA**

# Pashko Vasa, Vaso Pashë Shkodrani (1825-2025)

Përjetimet e Shkodrës në mes dy datash, dy ngjarjesh, e kaluara 25 Qershor 1978 dhe sot, 17 shtator 2025.

Natyrisht, nuk janë data të veprimitarisë së tij njerëzore dhe politike, por ngjarje që rilindësi ynë, nuk i përjetoj në vete të parë, por janë të tija që shënjuan caqe kur ai ishte në dimensione të "pandërgjegjësme", por që të dyja kanë ndodhur në vendlindjen e tij-Shkodër.

## 25 Qershor 1978, e diele.

Qyteti u zgjua për të përmbushur një detyrim dhe një mirënjohje të thellë për birin e tij, një akt sublim dhe qytetar po aq edhe njerëzor. Kishte një javë që, mbi shtratin e një topi kishte mbërritur ark-morti me eshtrat e patriotit të madh, birit të Shkodrës, rilindësit të çështjeve kombëtare dhe njërit nga ideologët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që kishte lanë qytetit të tij të lindjes qysh nga viti 1848, në moshën 23 vjeçare, dhe tash Shkodra e tij duhet ta përcjellë të prehet përjetësisht në vendlindje. Mbi 11000 vetë, popull dhe shtresa të ndryshme shoqërore, shkuan gjatë javës në shtëpinë e tij të lindjes (tashmë ajo ishte shndërruar në Shtëpi Muze e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Shkodrën), ku ishte vendosur arkivoli me eshtrat e tij dhe atë të diele, kanë dalë për ta përcjellë me nderim e respekt të thellë për në varrezat e dëshmorëve të atdheut. Në orët e para të mengjesit në një nga sallat e Komitetit Ekzekutiv të K.P të Rrethit, pranë arkivolit me eshtrat e patriotit bën roje nderi, popull, por edhe autoritetet shtetërore e lokale.

Në orën 8.00, në sheshin e lagjes "Qemal Stafa" organizohet një meeting i madh, pastaj arkivoli i vendosur mbi shtratin e topit, i mbuluar me flamurin kombëtar, i prirë nga dekoratat, dhe kurora të shumta, i shoqëruar nga truproja e nderit dhe banda e qytetit, iu drejtua Varrezave të Dëshmorëve në një vend pranë dëshmorëve të periudhës para Luftës së Dytë Botërore, për tu prehur përjetësisht.

Në këtë kuadër, u mbajt edhe një Session shkencor në një nga sallat e Institutit të Lartë Pedagogjik (sot Universiteti "Lu-

igj Gurakuqi").

Në lagjen rrëzë kalasë "Rozafa" u inaugurua një lapidar kushtuar Degës së Lidhjes Shqiptare të Shkodrës, vepër e dy skulptorëve shkodranë, në basorelievin e të cilit janë shkruar vargjet e poemës kushtim "Mori Shqypni, e mjera Shqypni", 1880:

*Asht tok' e jona t'parët na kan lan,  
Kush mos ta preki, se desim t'tan!*

## 17 shtator 2025, e merkurë.

### Pashko Vasa - 200 vjet (1825-2025).

Një ngjarje tjetër në Shkodër, një ceremoni tjetër, e bukur, përkujtimore, e gëzuar, e mirëmenduar, e përgaditur me plot dëshirë, përkushtim dhe me shumë emocione, nga një brez tjetër qytetar, nga personalitete të tjera vendore, akademike dhe qytetar të thjeshtë, të lagjes ku u lind patrioti me në krye pasardhës nga familja e Pashko Vasës, krejtë të tjerë nga ato të 1978-s.

E njëjta piknisje, nga ajo godinë ikonike e Shkodrës, dikur Saraji i pushtetarëve turq, (Guvernator i asaj Perandorie në Bejrut ishte Pashko Vasa), ish godinë e Komitetit Ekzekutiv për disa dekada nga ku doli arkivoli i rilindasit tonë në 25 qershorin 1978, e sot godina e Bashkisë së Shkodrës nga ku një kortë zyrtar dhe personalitete akademike të Shkodrës, dhe të disa universitetëve nga Tirana, Elbasani, Gjirokastra, por edhe shumë pedagogë nga universitetet e Kosovës, edhe nxënës shkollash të ndryshme, u nisën për në ato varreza ku prehen dëshmorët e atdheut, edhe ai, Vaso Pashë Shkodrani.

Nën Hymin kombëtar dhe marshe funebre, me kunora dhe lule, me minuta heshtje me ndjenjën dashurie për dëshmorët dhe rilindasin tonë u bënë homazhet e rastit. Në kthim edhe një ndalesë te busti i Pashko Vasës në lulishtën pranë shkollës "Ndoc Mazi" duke e vështruar atë burrë të asaj lagje të Shkodrës, rruga që të çon te shtëpia e tij muze, mban emrin e tij prej disa dekadash.

Konferenca Shkencore për 200 vjetori e Pashko Vasës u mbajt në ambjentet e



shtëpisë së tij muze, një ndërtesë tipike qytetare shkodrane, dy katësh me çardak, shkalla të gurta, një oborr para banesës ku janë të vendosura objektet karakteristike si pusi, govata, lugu e enë të ndryshme, të gjitha të gdhendura me mjeshtri në gur.

I gjithë ky ansambël arkitektonik,

dhe artefakte të tjera të vendosura enkas për këtë veprimtari, i futen referuesit e kumtesave (duhet thënë, dhe ky ishte një mendim i të gjithë auditorit) se, të gjitha referatet ishin në një nivel të lartë shkencor, dhe referuesit u ndjenë në një botë të shekullit të 19-të nga e cila ato e panë vehtën "të përkedhelur" sepse, aty në ato ambiente e ndjenin se djaloshi i dikurshëm shkodranë, ai për të cilin po referonin, i përkiste një familje qytetare të epërme, larg salltaneteve të oborreve perandorake të botës ku "dishepulli" i tyre e kishte çuar jetën në mërgim, në luftra dhe detyra të rëndësishme të kohës së shkuar, por që i dha famë edhe për atdheun e tij Shqipërinë dhe Shkodrën, të cilat nuk i pa kurrë ma, por i gëzoi në Amshim!

### Shënim:

Shumë referenca janë marrë nga shtypi i kohës dhe nga libra të shkruar për të, sidomos nga libri i Prof. Vehbi Bala.

Ditë e bukur sot në Shkodër, me 17 shtator 2025!

LEONARD QYTEZA



# Përkujtim me nderime për kapiten Eduard Kreuzig dhe ushtarët austro-hungarezë në Shkodër

Në Shkodër u zhvillua një ceremoni përkujtimore në nder të kapitenit Eduard Kreuzig dhe dhjetëra ushtarëve të tjerë të ushtrisë austro-hungareze, të cilët prehen në këtë qytet pa u përmendur emër për emër gjatë Luftës së Parë Botërore.

Veprimtaria u organizua me rastin e vizitës së Presidentit të përfaqësues së Vjenës të Kryqit të Zi Austriak, z. Claus Heitz, dhe mbledhjes së bashku përfaqësues të lartë të Ambasadës Austriake, Ambasadës Çeke, Komandantin Robin Kalina, përfaqësues të Ambasadës Hungareze, ekspertin e integritetit z. Erik Haupt me familje, Konsullin e Nderit të Austrisë në Shkodër z. Gjergj Leqejza, si dhe personalitete të tjera ushtarake si kolonelët në pension Flamur Muça dhe Ndue Sanaj. Të pranishëm ishin gjithashtu përfaqësuesi i Kryqit të Zi Austriak në Shqipëri, z. Florian Doschek, organizata të shoqërisë civile si Malteser dhe Paqe dhe Drejtësi, drejtuesi i shkollës profesionale austriake Peter Mahringer, si dhe dashamirë të kauzës për ruajtjen e kujtesës historike.

## Kush ishte kapiten Eduard Kreuzig?

Eduard Kreuzig lindi në vitin 1882 në Königrätz (Çeki). Në vitin 1914 u gradua kapiten dhe iu bashkua Shtabit të Përgjithshëm Austro-Hungarez. Për meritat dhe trimërinë e treguar gjatë luftimeve në Shqipëri, Galici, Serbi dhe Mal të Zi, më 6 qershor 1916 ai u propozua për një nga dekoratat më të larta ushtarake të Perandorisë.

Megjithatë, nuk arriti ta merrte këtë nderim për së gjalli. Kreuzig ndërroi jetë më 18 korrik 1916 në spitalin e epidemive në Shkodër, i prekur nga tifoja. Dekorata iu akordua vetëm pas vdekjes, më 9 gusht të po atij viti. Për Kryqin e Zi Austriak, kujtimi i këtij varri ka një domethënie të veçantë, pasi simbolizon edhe fatin e qindra ushtarëve të tjerë të rënë që nuk kanë më shenja identifikuese.



## Ceremonia përkujtimore

Nga Ministri Provincial, Padër Pashko Gojçaj, së bashku me një bashkëshërbyes të Urdhrit Françeskan, u dha një meshë e shkurtër për shpirtin e të vdekurve, të përfaqësuar në mënyrë simbolike nga varri i Kapiten Kreuzig. Me këtë rast u vendosën kurora lulesh, ndërsa z. Heitz solli

një shirit të posaçëm komemorativ nga Kryqi i Zi Austriak.

Një moment i veçantë i ceremonisë ishte falënderimi i përfaqësuesve të Kryqit të Zi Austriak për një qytetar shkodran që, për shumë vite, është kujdesur me përkushtim për mirëmbajtjen e varrit të kapitenit Kreuzig, duke e mbajtur atë në

gjendje të shkëlqyer. Për këtë arsye, Konsulli i Nderit, z. Gjergj Leqejza, u nderua nga Kryqi i Zi Austriak me një medalje mirënjohjeje për kontributin e tij në ruajtjen e kujtesës historike dhe përcimin e vlerave të përbashkëta.

Ceremonia përfundoi me një mesazh të qartë respekti dhe mirënjohjeje, si



për sakrificat e ushtarëve të huaj që ranë në këto troje, ashtu edhe për kujdesin e treguar nga qytetarët vendas ndër vite për ruajtjen e kësaj trashëgimie. Aktiviteti u mbyll me një drekë miqësore në Bar-Restaurant "Elita".

## Vizitat e tjera gjatë ditës

Delegacioni i Kryqit të Zi Austriak zhvilloi edhe vizita të tjera përkujtimore në zonë. Në Prekal u mbajt një ceremoni pranë memorialit kushtuar dy ushtarëve të rënë, duke nënvizuar respektin dhe mirënjohjen për kujdesin e treguar nga banorët e zonës. Më pas, delegacioni u ndal te Ura e Vjetër e Bunës, ku ndodhet guri memorial që dëshmon ndërtimin e rrugës Shkodër-Shirokë nga forcat austro-hungareze gjatë viteve 1916-1917.

Pas përfundimit të ceremonisë në varrezat e Rr'Majt për kapiten Kreuzig, delegacioni udhëtoi drejt Lezhës, në zonën e Markatomaj, ku inspektoi një varrezë të sapo zbuluar. Sipas të dhënave të para, aty mund të prehen rreth 326 ushtarë austro-hungarezë, duke e shndërruar këtë zbulim në një element me rëndësi për studimet historike dhe ruajtjen e kujtesës.

E gjithë dita u zhvillua në frymën e nderimit dhe kujdesit për trashëgiminë historike, duke lidhur të shkuarën me të tashmen dhe duke përcuar mesazhin e respektit dhe pajtimit ndërmjet popujve.

MIKELA LEKAJ,  
JONA LEQEJZA

# Mbresa nga Takimi Kombëtarë i Lahutarëve - 2025 ("Shpella e Frashnit", Bajzë, Malësi e Madhe)

Të shpalosësh në një veprimtari të tillë gjithë arsenalin etnokulturës të një treve apo të mbarëkombëtar, është e pamundur, por e rëndësishmja qëndron tek ajo që brenda mundësive e kohështirjes arrin të lësh gjurmë dhe të përçosh "mesazhe" tek bashkësia e brezat e sotëm e të nesërm, se ne i kemi vlerat, kemi potencialet e ja tek janë në formë e në përmbajtje për ti shpalosur me gjithë shpirtë e zëmër e patjetër edhe me profesionalizëm.

Duke falënderuar institucionin tonë, Bashkia Malësi e Madhe e Kryetarin e Bashkisë Tonin Marinaj, për mbështetjen financiare e Shoqatën Kulturore e Artistike "Logu Bjeshkëve", me drejtues Mjeshterin e Madhë e Lahutarin mjaft të njohur, Pretash Nilaj për organizimin e kësaj veprimtarie madhështorë, dua të veçoj disa nga mbresat e mia rreth kësaj ngjarjeje:

Pjesëmarrja e lahutarëve, me këngë të zgjedhura pothuajse nga gjitha trevat tona shqiptare e nga diaspora çka e bëri edhe më të bukur spektaklin.

Vlerësimin që i bëri Shoqata "Logu i Bjeshkëve" me "Çertifikatën Mirënjohje", Lahutarin Legjendarë të madhin Jonuz Delaj, për çdo gjë që ai ka dhënë me disa dhjetëra vite si lahutarë, folklorist, këngëtar, autorë tekstesh, kostumografi e të tjera e të tjera, ku pata edhe kënaqësinë t'ia dorëzoj personalisht e duke gjetur rastin ti uroj shëndet të plotë e jetë sa më të gjatë.

Shembulli i gjallë se lahuta e këngët epike nuk duhen të "rrudhën" brenda një treve a krahine, por se po merr përmasa të gjëra edhe në vise të tjera shqiptare siç është edhe rasti i tiranasit Marsel Meta, fitues i disa çmimeve me



lahutë e këngë.

Dhe si qershia mbi tortë qëndrojnë pjesëmarrja e 3 të rinjve (dy vajzat dhe djali) i familjes së nderuar kelmendase Anton Preldakaj, që na bën vërtetë të besojmë se rron tradita në Malësinë e Madhe falë mbështetjes dhe dashurisë që kanë prindërit e tyre, por dhe vullneti e dëshira e vetë këtyre të rinjve.

Ne duhet ta përçojmë më tej këtë veprimtari të nisur si një traditë mjaft domethënëse, duke mbrojtur me fanatizëm lahutën si pjesë e patjetërsueshme e trashëgimisë sonë etnokulturave, duke i thënë botës mbarë se kjo vegël muzikore ka qenë e mbetet pjesë e jona mbarëkombëtare shqiptare.

Sytki Ndreca



# GJAKU QË THIRRI LIRINË

## Sokol Veshtaj - Martiri i Lirisë

Në Malësinë e Madhe, aty ku malet lidhen me qiellin, më 10 prill 1965 lindi Sokol Veshtaj. Një djalë i qetë, i zgjuar e i dashur nga të gjithë, që rritej me ëndrrën e një jete të lirë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu me rezultate të shkëlqyera në Bajzë, por rruga e tij drejt dijes u ndërpre. Regjimi komunist ia mohoi të drejtën e studimeve të larta, vetëm pse vinte nga një familje e persekutuar politikisht.

Në vitin 1985 u thirr për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak në Vlorë, në repartin e xhenios, ku jetoi nën vëzhgimin e përhershëm të Sigurimit të Shtetit, gjithmonë i dyshuar e i ndjekur.

Në shtator 1986, martesa e motrës e ktheu për pak ditë në vendlindje, por gëzimi i dasmës nuk ia largoi hijen e rëndë të diktaturës. Ai vendosi të arratisë. Bashkë me shokun e tij, Gjesh Gjesh, u nisën drejt Jugosllavisë, drejt ëndrrës së lirisë. Kaluan shtatë ditë e shtatë net nëpër malet e Kelmendit, mes urisë, lodhjes dhe ndjekjes nga forcat kufitare e çetat vullnetare.

Natën që po gdhinte 2 tetori 1986, dy krizma pistolette përçarë qetësinë e Vermoshit. Sokoli ra në pritë pranë kufirit, u plagos rëndë dhe, i paarmatosur, u ekzekutua nga afër. Nga një distancë prej 1.5 metrash, një oficer kufiri e qëlloi dy herë në ballë. Në xhepin e tij u gjet vetëm një adresë dhe fotografia e vëllait Nikollës në Amerikë, i arratisur që në vitin 1966. Aty mbyllej ëndrra e udhëtimit drejt lirisë.

Trupi i pajetë i Sokolit u lidh bashkë me shokun e gjallë dhe u transportua në karrocërinë e një xhipi. I shëtitën nëpër fshatrat e Malësisë, nga Vermoshi deri në Shkodër, duke detyruar banorët t'i shanin e t'i pështynin. Ishte një akt makabër, një mesazh i qartë: kush kërkon lirinë, paguan me jetë.

Trupi nuk iu dorëzua familjes. Eshtrat e tij u hodhën fshehurazi, të lidhur me tela, në Kuç, pranë nënstacionit të Radio Shkodrës, nën ruajtjen e ushtrisë. Vendi iu tregua më vonë kushëririt të tij, Gjovalin Veshtaj, nga inxhinieri Nikolin Ndoci. Ndërkohë, familja Veshtaj vuajti pesë vite internim në Dush të Komani, pesë vite dhimbje, pa e ditur ku prehej biri i tyre.

Pas rënies së diktaturës, në vitin 1991, trupi i Sokolit u rivarros me nderime. Mijëra banorë të Malësisë e më gjerë morën pjesë në ceremoninë ku ishte i pranishëm edhe Pjetër Arbnori, Kryetar i Parlamentit të kohës. Ishte një ditë lotësh, dhimbje dhe krenarie.

Në vitin 1996, Presidenca e Republikës e shpalli Dëshmor të Atdheut. Më herët, ai ishte shpallur Martir i Demokracisë. Emri i tij u kthye në testament të çmimit të lirisë.

Në shtator 2025, Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe shpalli pas vdekjes Sokolin "Qytetar Nderi". Në ceremoninë zyrtare, me praninë e familjarëve, miqve dhe përfaqësuesve të pushtetit vendor, Kry-

etari i Bashkisë, Tonin Marinaj, dorëzoi titullin me motivacion: "Për vlerat e larta të lirisë dhe të drejtave demokratike, me qëllimin e shenjtë të vendosjes së pluralizmit në Shqipëri, duke përmbushur më së miri idealet shumëshkëlqyeshme euroat-

të mbetur në piedestalin e krenarisë, jo vetëm në trevën e Malësisë së Madhe, por në mbarë kombin shqiptar."

Në emër të familjes, falënderuan Nikoll Veshtaj dhe Gjovalin Veshtaj. Kujtimet e dhimbshme, fjalimet dhe kënga kushtuar

vetëm historia e një djali 21-vjeçar që ëndërronte lirinë. Është historia e sakrificës së një familjeje, e dhimbjes së një krahine dhe e plagës së një kombi. Ai u vra në kufi, por historia e tij e kaloi kufirin e kohës. Historia e Sokolit nuk është vetëm



lantike, ku tashmë vendi ynë ecën në rrugën pa kthim në aleancë me Bashkimin European dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës; aspirata këto që u bënë realitet vetëm falë guximit dhe sakrificës deri në flijim të jetës së Sokol Veshtajt me shokët e tij kundër diktaturës bolshevike, për

Sokolit sollën lot, dhimbje dhe krenari.

E gjithë kjo veprimtari u realizua falë përkushtimit të thellë të artistit të mirënjohur, zemërbardhë dhe patriot i madh, malësorit krenar z. Engjell Çuli, me banim në Londër. Figura e Sokol Veshtajt u përjetësua përmes një kënge me tekst të Ramazan Çekës, kompozuar nga shpirti malësor dhe duart e arta të vetë Engjellit. Kënga u orkestrua mjeshtërisht nga Luan Dagistani dhe u këndua me melosin e fuqishëm malësor nga lahutari Pretash Nilaj, "Mjeshtër i Madh", ku melosi i Malësisë kumboi si një thirrje brezash, duke mbajtur gjallë kujtimin dhe krenarinë e vendlindjes.

Historia e Sokolit nuk është

historia e një djali 21-vjeçar që ëndërronte lirinë. Është historia e sakrificës së një familjeje, e dhimbjes së një krahine dhe e plagës së një kombi.

Ai u vra në kufi, por historia e tij e kaloi kufirin e kohës. Emri i tij është sot një flamur krenarie për Malësinë dhe për gjithë Shqipërinë, dëshmi e gjallë e mizorisë së diktaturës dhe udhërrëfyes për brezat që vijnë.

Sokol Veshtaj (1965-1986), Martir i Demokracisë, Dëshmor i Atdheut, Qytetar Nderi i Malësisë së Madhe.

I përjetshëm qoftë kujtimi yt, Sokoli i Malësisë! Djalë 21-vjeçar, por me zemër sa një komb i tërë.

**Nga RAMAZAN ÇEKA,**  
Shtator 2025



# VRANA KONTI

Vrana Konti ose Kont Urani (italisht: conte d'Urana ose Brana Conte, 1389 - 1458) ka qenë një prijës ushtarak arbër që u shqua gjatë luftërave arbro-osmane si njëri prej komandantëve të Gjergj Kastriotit, duke qenë gjithashtu ndër këshilltarët më të afërt të tij. Me shumë gjasa qe pjesë e zotërve të vegjël feudal të lidhur me Kastriotët, dhe është e mundshme të kishte lidhje farefisnore (miqësie) me ta. Në rininë e tij qe mercenar ndër ushtritë e Alfonsit të Madhnishëm. Titulli kont, me të cilin iu shqua emri nuk kishte të bënte me rangun fisnikëror, të cilit i përkiste, por statusit si personalitet me rëndësi në mjedisin ku veçoi dhe një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Gjergj Kastriotit. Deri në vdekjen e tij, në 1458 ai ishte këshilltar i Tij dhe një nga komandantët e tij më të mirë.

Vrana Konti ka marrë pjesë në të gjitha betejat e mëdha të Gjergj Kastriotit deri në 1458. Ai është i njohur kryesisht për rezistencën e tij në detyrën komandant i garnizonit shqiptar gjatë rrethimit të parë të Krujës. Atij iu propozua nga Sulltani Murati i II një shumë e madhe parash dhe një post i nivelit të lartë në administratën e osmanëve si një kusht për dorëzimin e tij, por ai e refuzoi këtë ofertë. Në kulturën shqiptare ai është i përfaqësuar një njeri i mençur dhe këshilltar i Gjergj Kastriotit. Ai ishte një prej princave shqiptarë që morën pjesë në Lidhjen e Lezhës në vitin 1444, një aleancë ushtarake e formuar nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, për të luftuar kundër Perandorisë Osmane. Vrana Konti, emri i të cilit njihet edhe si Vranan Uran Kont, ishte një nga komandantët më të besuar të Gjergjit dhe luajti një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e territoreve shqiptare. Ai është përmendur veçanërisht për qëndresën e tij në Kështjellën e Krujës, ku udhëhoqi mbrojtjen kundër rrethimeve osmane.

Në historiografi, ai përfaqëson trimërinë dhe përkushtimin për mbrojtjen e atdheut dhe është një figurë e respektuar në traditën kombëtare shqiptare. Në disa burime, ai identifikohet si babai i Andrea Vranës, një tjetër figurë e njohur e kohës. Vrana Konti vinte nga një familje feudale shqiptare që gojëdhëna e lidhen me Rekën e Epërme, Rimnicën, Skertecin bjeshtë e Tanushës, "rrasat e varrit /vorrit" dhe "vorret e kondes".

Vrana Konti ndryshe njihet edhe si hero i Krujës, është veçanërisht i njohur për mbrojtjen heroike të Krujës gjatë Rrethimit të parë të Krujës në vitin 1450. Kur Gjergji po organizonte forca në rajone të tjera, ai ia besoi Vrana Kontit komandimin e garnizonit të Krujës. Pavarësisht sulmeve të fuqishme nga trupat osmane të udhëhequra nga sulltan Murati II, Vrana Konti arriti të mbante kështjellën të pashyeshme. Kjo fitore kishte një rëndësi të madhe strategjike dhe morale për shqiptarët dhe për rezistencën evropiane ndaj Perandorisë Osmane.

Figura Shembullore e Trimërisë dhe Besnikërisë.

Vrana Konti përfaqëson tiparin e kapedanëve shqiptarë të Mesjetës – trim, i mençur, i vendosur dhe mbi të gjitha, besnik ndaj çështjes kombëtare. Në shumë burime historike, ai përshkruhet si një njeri i nderuar, i cili gëzonte respekt të madh si nga populli, ashtu edhe nga vetë Gjergji. Emri i tij lidhet me besnikërinë ndaj betimit dhe aftësinë për të përballuar sfida të mëdha ushtarake. Trashëgimia. Disa burime e lidhin Vrana Kontin si përfaqësues të një linje familjare që vazhdoi më vonë në shërbim të krishterimit dhe luftës kundër osmanëve. Emri i tij është përmendur në letërsi dhe historiografi si simbol i heroizmit shqiptar.

Lidhja me Rekën e Epërme.

Disa studiues dhe burime të traditës historike lokale e identifikojnë Vrana Kontin si me origjinë nga Reka e Epërme, – zona që kanë ruajtur me kujdes kujtimet për figurat historike shqiptare. Në këto treva, emri i "Vranës" ruhet edhe në gojëdhëna, këngë popullore dhe toponime të vjetra. Përmendja e origjinës së Vranës nga Reka e Epërme ka rëndësi jo vetëm historike, por edhe identitare. Ajo tregon se edhe zonat më të thella dhe më pak të njohura të trojeve shqiptare kanë dhënë kontribut në qëndresën ndaj pushtimeve osmane dhe në udhëheqjen kombëtare. Kjo lidhje forcon ndjesinë e përkatësisë dhe krenarisë historike për banorët e Rekës dhe Dibrës në përgjithësi.

Gojëdhëna për varrin e Vrana Kontit.

Në zonën e Rekës së Epërme, në kanionin dhe grykën e malit Korab, buzë Majës së Madhe dhe Malit Kabash, në fshatin Rimnicë (Lumnicë) afër fshatit Tanushë/Tanushejt (tana-nuse) e bjeshtës së Skertecit. Në atë kohë fshati Tanushë ishte vendi për rehabilitimin dhe shërimin ushtarëve bashkëveprues të Gjergjit, pasi ky territor ishte gjenerali më i madh i ushtrisë së Arbërisë Vrana Konti (Mëhallat e f. Tanushë ishin Gorga, Dushku, Barrallafi, T'kolës, Bregzajt, Lleshkajve, Zavojska, Grekajt, Nivishta/Ni-vishte/, Barallavi, Likajt e të tjera). Kurse fshati Rimnicë (Lumnicë, mhallat teme, garamhall, tet halirkave, kontallaret, trajcallaret, pallazhani, shullo e të tjera), që shtrihet po në të njëjtin kanion përballë malit Menikut, nën Livadhet e Priftit e Malit Kukul. Rrugës për Nivishtë, Grekaj e Tanushë prehen eshtrat gjeneralit Vrana Kontit ku edhe vet vendi ku janë të vendosura varrezat e fshatit mbanë emrin "te vorret e Kondes".

Gojëdhëna që u trashëgua ndër shekuj që thotë se Vrana Konti, pas shumë betejash, gjeti prehje në një varr monumental, i mbuluar me rrasa të mëdha guri, të cilat vet Vrana i kishte prurë nga Skerteci, bjeshtë e Tanushës. Sipas rrëfimeve popullore: - Rrasat janë aq të mëdha dhe të rënda, sa "vetëm burra me zemër luani mund t'i kenë vënë mbi një njeri të madh si Vrana Konti". - Thuhet se rreth varrit rriteshin disa dru të egër që askush nuk guxonte t'i priste, pasi besohej se ishin mbrojtës të prehjes së tij. - Legjenda thotë

se në net me hënë të plotë, lulet e egra që rriten mbi rrasat çelin papritur, si një shenjë që shpirti i tij është ende i gjallë në kujtesën e popullit. Simbolika, Rrasat nuk janë thjesht gurë varri në gojëdhëna – ato përfaqësojnë peshën e historisë dhe nderit, dhe qëndrueshmërinë e sakrificës. Populli i zonës i referohet atyre si "rrasat e besës", sepse besa dhe qëndresa janë vlerat me të cilat identifikohet figura e Vrana Kontit. Përmendje në kujtesën popullore, shpesh në rrëfime thuhet: "Aty ku janë rrasat e Kondës, toka së harron historinë."

Ai që kalon andej, duhet me i hedh një lutje në heshtje. "Rrasat e Vranës – një gojëdhënë nga Reka e Epërme. Në majë të një kodre të qetë të Rekës së Epërme, aty ku toka flet me gjuhën e gurit dhe era fëshfërin si lutje e vjetër, ndodhen rrasat e varrit të Vrana Kontit – figurës legjendare shqiptare, dorës së djathtë të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Populli thotë se kur Vrana Konti ra, pas një jete të mbushur me beteja dhe lavdi, trimat e Rekës mbajtën zi për shtatë ditë e shtatë net. Trupi i tij u vendos në një varr të gjerë, të thellë e të skalitur në zemër të shkëmbit. Mbi të, u vendosën tri rrasat të mëdha guri, të cilat

ende sot qëndrojnë, të heshtura e të rënda si amaneti i lënë brez pas brezi. Thuhet se rrasat u latuan me dorë, nga gurë të nxjerrë në majë të malit në Skertec dhe të sjellë mbi supe nga vet Vrana ditën kur kthehej nga luftërat para se të vdiste. Nuk përdorën kuaj, ishin burrat që, me dhimbjen në zemër dhe nderin në ballë, e çuan heroin e tyre në prehjen e fundit.

Gurët nuk plasnin!

Gurët tregojnë!

Në to s'ka shkrim, por ka histori. Banorët rrëfejnë se netëve me hënë, rrasat marrin një dritë të lehtë blu, si kujtim i shpirtit luftarak, që nuk u dorëzua kurrë. Gratë e moshuara u tregojnë fëmijëve se lulja që çel mbi rrasat nuk rritet askund tjetër në Reka – një lule e vogël, me ngjyrë të kaltër dhe aromë të hollë, e quajtur në gojëdhëna "lule e besës". Dhe kur ndonjë i huaj ndalet pranë rrasave, banorët thonë: "Mos bëj zhurmë. Aty pushon Vrana. Dhe ndero, se mbi ato rrasat është shkruar historia jonë."

Nga ENIS RAFET JAKUPI



# Varfëria mbetet ende si “Guri i Sizifit” mbi shpatullat e njerëzimit



Dr. Kujtim Çako

Është për të përshëndetur e vlerësuar përbërja e Kuvendit të ri me mbi 20 % ekonomistë.

Pa ekonomiste dhe pa “skaner të ekonomisë”, pa matëse konkrete, pa rolin rregullues të Qeverisë, nuk ka minimum jetik, nuk ka zhvillim, nuk ka mirëqenie të njerëzimit.

Varfëria mbetet akoma si “Guri i Sizifit” mbi shpatullat e njerëzimit.

“Lufta kundër varfërisë, në aspektin e rregullimit (kompensimit) të çmimeve dhe inflacionit është i pamjaftueshëm kudo, që behet dhe çon në rënien e fuqisë blerëse të konsumatorëve dhe të prosperitetit”. - sipas ekonomistit Dr. Kujtim Çako

Në mbarë botën, afërsisht 677 milionë njerëz pritet të jetojnë në varfëri ekstreme në vitin 2025, me një të ardhur prej më pak se 2.15 dollarë në ditë duke përfaqësuar një ulje të konsiderueshme, por të ngadaltë, pasi varfëria ekstreme pritet të eliminohet plotësisht deri në vitin 2030.

Megjithatë, varfëria u intensifikua në Gjermani në vitin 2024 dhe shkalla e varfërisë u rrit, veçanërisht për shkak të inflacionit, i cili zvogëlon fuqinë blerëse të njerëzve me të ardhura të ulëta.

Trendi: Edhe pse varfëria globale ka rënë ndjeshëm në dekadat e fundit, nuk pritet të eliminohet plotësisht deri në vitin 2030, por pritet të bjerë në afërsisht 622 milionë njerëz. Situata në Gjermani (2024/2025): Shkalla e varfërisë: Sipas Paritätischer Armutsbericht (Raportit të Varfërisë Paritätische), shkalla e varfërisë u rrit me 1.1 pikë përqindje në 15.5 përqind të popullsisë në vitin 2024.

Inflacioni: Inflacioni i lartë ka përkeqësuar situatën për njerëzit me të ardhura të ulëta, duke çuar në një humbje të konsiderueshme të fuqisë blerëse. Grupet e prekura: Prindërit beqarë, të rinjtë dhe pensionistët janë veçanërisht të prekur nga varfëria

Objektivi 1, i Zhvillimit të Qëndrueshëm i Kombeve të Bashkuara synon të zhdukë varfërinë ekstreme deri në vitin 2030. Një pjesë e madhe e njerëzve që jetojnë në varfëri ekstreme jetojnë në Afrikën Sub-Sahariane, ku nëntë nga dhjetë njerëz të varfër pritet të jetojnë deri në vitin 2030. 1)

Burimi:

Varfëria p, sh . në Gjermani është rreth 13 milionë njerëz jetojnë në vijën e varfërisë. Kjo përfaqëson 15.5 përqind të popullsisë, sipas Paritätischer Armutsbericht 2025. Shkalla e varfërisë e llogaritur, duke përdorur të dhëna nga viti 2024 ishte 1.1 pikë përqindjeje

më e lartë se në vitin e kaluar. Kjo është hera e parë që nga viti 2020 që shkalla e varfërisë është rritur me këtë shumë. Raporti i varfërisë tregon gjithashtu se inflacioni i lartë prek veçanërisht njerëzit e varfër. Sipas raportit, të ardhurat mesatare të njerëzve nën vijën e varfërisë në vitin 2024, të përshtatura për inflacionin, ishin vetëm 921 euro në muaj. Në vitin 2020, ishin 981 euro. 2)

Numri i njerëzve në varfëri ekstreme 2024 në shifrën 692, 2025 do të jete 677, 2026 në 664 dhe 2027 në 646 milion njerëz.

Trajtimi i këtij problemi të rëndësishëm në shoqërinë e sotme :

Kur çmimet dhe inflacioni rriten, qeveritë ose kompanitë shpesh përgjigjen me të ashtuquajturat masa kompensimi apo përshtatje, të tilla si:

- Rritje të pagave;
- Subvencione qeveritare ose pagesa transferuese (p. sh., subvencione të kostos së ngrohjes, kufizime të çmimeve të energjisë);
- Lehtësim tatimor.

Këto rregullime kanë për qëllim të zbutin humbjet reale të pësuar nga popullsia për shkak të inflacionit.

Megjithatë, kjo politikë kompensimi nuk është e mjaftueshme dhe as siguron “fuqi blerëse reale në planin afatgjatë”.

Arsyet e mundshme për rënien e fuqisë blerëse pavarësisht kompensimit:

1. Pagat rriten më ngadalë se çmimet: P.sh. nëse inflacioni është 6%, por

pagat rriten vetëm me 3%, konsumatorët humbasin 3% të fuqisë së tyre blerëse reale.

2. Kompensimi është shpesh vetëm afatshkurtër: Ndihtma qeveritare (p.sh., kufizime të çmimeve të energjisë) është e përkohshme dhe nuk kompenson të gjitha rritjet e çmimeve.

3. Inflacioni ka një efekt regresiv: Rritjet e çmimeve i godasin më fort familjet me të ardhura të ulëta, pasi ato shpenzojnë një pjesë më të madhe të të ardhurave të tyre për mallra konsumi (si energjia dhe ushqimi).

4. Përshtatja strukturore nuk materializohet: Menaxhimi i qëndrueshëm i inflacionit kërkon reforma strukturore (p.sh., në tregun e banesave dhe sektorin e energjisë), jo vetëm kompensim financiar.

“Prosperitet në rënie”, për këto argumente :

- Të ardhurat reale “tkurren” apo ngrijnë .
- Fuqia blerëse dhe konsumi bie
- Kursimet humbasin (ulin ) vlerë në raport me rritjen e inflacionit dhe të çmimeve
- Pabarazia sociale mund të rritet

Përfundimi:  
Ekonomistët me profesionalizmin dhe idetë e tyre duhet të sjellin domosdoshmërisht qasje e risi në përshtatje me veçoritë drejt kritereve e normave të BE-së dhe anëtarësim sa më të shpejt të Shqipërisë.

“Mirëqenia” në kushtet e rritjes së inflacionit dhe të rritjes së çmimeve do të ulet ajo, me uljen e fuqisë blerëse. Kjo do të thotë: Me të njëjtat të ardhura (rrogë mujore ) konsumatori blenë dhe konsumon apo përdor më pak artikuj e shërbime të domosdoshme baze jetike dhe masat e kompensimit nga qeveritë vetëm zbutin situatën, por nuk zgjidhin problemin jetik.

Mendoj, në një fare shkalle faktin se politika aktuale mbështetet shumë në kompensimin simptomatik në vend që qeveritë të merren me problemet themelore ekonomike, siç janë pengesat në furnizim, çmimet e energjisë ose stanjacioni i produktivitetit e të tjera .

Rezultati është një humbje reale e mirëqenies (e prosperitetit), pavarësisht (ose për shkak të) “përshtatjes” së dukshme. 3)

Burimi:

- 1) Informacion shtesë: OZH 1
- 2) Sipas Paritätischer Armutsbericht (Raportit të Varfërisë së Barazisë),
- 3) Dr. Kujtim Çako libri “ Te drejta te pa fituara “f.206 – 234, viti 2022.

**Në botë, 677 milionë njerëz do të jetojnë në varfëri ekstreme në vitin 2025, me një të ardhurë prej më pak se 2.15 dollarë në ditë**



# VERA GJONAJ – NJË EMËR I NJOHUR I DIASPORËS SHQIPTARE NË ITALI



XHELAL MARKU

Kur studion dhe zbulon figura të shquara dhe me kontribute, doemos shkrintari frymëzohet, por ndjen dhe një kënaqësi të veçantë, pasi përmbush një nga qëllimet e tij, që është përzgjedhja e personazheve, që ai i ka vënë detyrë vetes, për t'i përfshirë në librin e tij të radhës. Dhe këtë kënaqësi, e pata dhe unë, miqtë e mi, kur mësova vlerat e spikatura të emigrantëve shqiptarë në Itali, poetes dhe prozatores - Vera Gjonaj.

Ajo përfaqëson denjësisht figurën e ndritur dhe fisnike të femrës shqiptare në diasporë. Vera Gjonaj është një grua e thjeshtë, me një kulturë të gjërë, komunikuese dhe e aftë, e cila gjatë gjithë karrierës së saj, ka ndriçuar si një yll i vërtetë, duke shpalosur në veprimtarinë e saj, vlerat e veta intelektuale e njerëzore. Ajo, është një aktiviste atdhetare, publiciste dhe shkrintare, që mbart vlera dhe virtyte, të cilat përcjellin përherë, mirësi e pozivitete dhe rrezaton dritë në punën e saj. Kjo është poetja Vera Gjonaj, **një femër intelektuale kuksiane**, e cila sot, është bërë një emër i njohur në diasporën shqiptare në Itali. Emrin e Vera Gjonajt, unë e mësova nëpërmjet rrjeteve sociale, ku prej vitesh, ajo ka shpalosur gjithë veprimtarinë e saj krijuese, humane dhe atdhetare, me një kontribut të shquar për Kombin tonë Shqiptar. Ajo është një grua emigrante, që me punën e saj dinjitoze, ka rritur vlerat e shqiptarisë në mbarë globin. Dhe për të arritur deri këtu, Vera ka sakrifikuar shumë, ka përballuar shumë sfida, por me këmbënguljen e saj, i ka kapërcyer ato dhe ka ndërtuar jetën e vet normale, bashkë me familjen, në shtetin fqinj, në Itali.

Idea për të emigruar, thotë Vera, erdhi ashtu spontanisht, si shumë emigrantë të tjerë, në vitin 2000, me shpresën për të ndërtuar një jetë më të mirë. Kushtet e vështira ekonomike dhe sidomos trazirat e vitit të mbrapshtë të 1997-tës, ku mbizotëronte kaosi dhe pasiguria në vend, na imponuan këtë largim, edhe pse ishim pa mbështetje dhe pa adresë, se ku do të shkonim. Emigrimi ynë, tregon Vera, ishte një aventurë e vërtetë, pasi ne luajtëm me fatin, duke udhëtuar në det të hapur, me mjete të pasigurte, me dy fëmijë të vegjël,

ku veç Zoti na ka ruajtur...! E megjithatë ia dolëm, shpëtuam nga ky rrezik, por na u deshe të sakrifikonim shumë, edhe për t'u strehuar, e akomoduar edhe për t'u integruar, në një shoqëri të re e të panjohur italiane. Punësimi ishte më kryesori, më pas erdhi edhe problemi i shkollimit të dy djemve tanë, që kërkonte investime dhe sakrifica të mëdha. Për shumë arsye, ka qenë një sakrificë e jashtëzakonshme, rritja, edukimi dhe shkollimi i fëmijëve në emigracion. Jemi krenarë ne si prindër, për dy djemtë tanë (Veridjonin dhe Rezarjanin), vazhdon tregimin Vera Gjonaj, që nuk na e humbën mundin dhe i mbaruan me sukses studimet e dëshiruar. Kështu, djali i madh, Veridjoni, ka mbaruar studimet e larta për kontabilitet dhe ka marrë doktoraturë, ndërsa djali i vogël, Rezarjani, është diplomuar në degën mekanik-elektronik.

## ORIGJINA E FAMILJES SË VERA MUSLIUT - GJONAJT

Poetja dhe gazetarja e talentuar Vera Gjonaj, është një grua me origjinë nga qyteti i Kukësit. Madje, familja e saj është plotësisht qytetare kuksiane, e cila para se të përmytej nga Liqeni i Hidrocentralit të Fierzës, ka banuar në një lagje të Kukësit të Vjetër dhe më pas është vendosur me banim në Kukësin e Ri, ku një pjesë e familjarëve të saj, banojnë edhe sot. Dy prindërit e Verës: babai Musli Etemi dhe nëna Hate Bogdani - Etemi, të cilët nuk jetojnë më, njihen njerëz fisnikë e të sakrificës dhe mjaft punëtorë, që vetëm me punë krahu, kanë rritur dhe edukuar gjithsej, tetë fëmijë, pesë djem dhe tre vajza. Vera është më e vogla vajzë e familjes, të cilën nëna e ka lënë jetime, në moshën 15 vjeç. Babai i Verës - Musliu ishte një burrë i njohur në Kukës, i brumosur me traditat e hershme të besës e të fjalës, ishte pashkollë, por i zgjuar, ishte i bisedës në odat e miqve, por ishte dhe human, që i dëgjohej fjala dhe bënte mjaft ndërmjetësime, për pajtime në mes familjeve dhe individëve, sepse bashkësia ku jetonte, besonin tek gjykimi dhe drejtësia e tij. Ndaj e donin dhe e respektonin të gjithë në Kukës, pasi ai, si zemërmirë e shpirt-pastër që ishte, veç të mira kishte bërë, gjatë gjithë jetës së tij. Dhe si i tillë, Musliu ishte një emër autoritar, që i shkonte fjala, jo vetëm në familje, por edhe në shoqëri, në miqësi dhe në bashkësi.

Vera Gjonaj - vajza e vogël e Musliut dhe e Hates, ishte një fëmijë i shkathhtë dhe mjaft energjik, me një vullnet të fortë për dije e për shkollim. Qysh kur ishte e vogël, ajo shfaqti prirjet dhe dëshirat e saj për t'u shkolluar, si dhe talentin e pasionin për poezinë. Shkollën fillore, tetëvjeçaren dhe të mesmen (gjimnaz), ajo i mbaroi me rezultate shumë të mira, në vendlindjen e saj, në qytetin e Kukësit, ndërsa shkollimin e lartë, në profilin ekonomik, ajo e mbaroi në një fakultet të Tiranës, dhe u diplomua specialiste e financës. Pas diplomimit, ajo

u kthye në vendlindje, në Kukës, ku pati fat të njihej, me një djalë të shkëlqyer, të quajtur Idriz Gjonaj, nga Reçi i Malësisë së Madhe i Qarkut të Shkodrës, i cili asokohe, që emëruar kryezooteknik në rrethin e Kukësit. Idrizi dhe Vera, do të ishin çifti i ri ideal, i bashkëshortëve të mëvonshëm, që i njohu jeta, puna dhe veprimtaria e tyre, si bashkëqytetar të Kukësit. Dhe nuk do të zgjaste shumë, koha e fejesës së tyre, pasi shpejt do të vinte edhe martesja e çiftit, me një dasmë të bukur, që u bë në Reç të Malësisë së Madhe, ku Vera Musliu, do të shkonte nuse, në një trevë tjetër të veriut, me tradita të panjohura prej saj.

## DASMA E ÇIFTIT: VERA MUSLIU DHE IDRIZ GJONAJ

Ka qenë një ditë e bukur vjeshte, ajo e 6 tetorit të vitit 1989, kur u bë dasma e çiftit Vera Musliu nga Kukësi dhe Idriz Gjonaj nga Reçi i Malësisë së Madhe të Qarkut të Shkodrës. Tradita e dasmave të Kukësit, është mjaft e njohur, ku spikat muzika tipike me lodër e cyrle, si dhe vallet pafund të veriut, me kryevallen e Kukësit, që të shkund me ritmet e saj. Madje Vallja e Kukësit, me motivet e saj, është po aq e njohur dhe e përhapur, aq sa kërcëhet nga veriu në jug, ashtu si dhe Vallja Pogonishte, apo Vallja e Tropojës, e cila kohët e fundit, u bë pjesë e UNESCO-s. Pas asaj atmosfere të bukur dasme, që Vera përjetoj ditën e shtunë, në shtëpinë e vet në Kukës, të nesërmen ajo do të udhëtonte me plot emocione, për të shkuar nuse, në Reç të Malësisë së Madhe, ku e priste dhëndëri Idriz Gjonaj, bashkë me dasmorët, në një tjetër dasmë të bukur, por me një tjetër traditë. Sapo ka hyrë në oborrin e shtëpisë, ajo u befusua me pritjen shumë të ngrohtë të dasmorëve të shumtë, që këndonin të gjithë bashkë, si në kor, këngën e njohur: "Sa e bukur na ka dalë nusja...", të shoqëruar me duartrokitje të zjarrta, ku spikatnin veçanërisht gratë reçjane, me veshjen fantastike të krahinës, që ishte xhubleta, tashmë edhe kjo pjesë e trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-s. U befusua thotë Vera dhe më mbetën sytë tek ajo veshje e bukur e karakteristike e Malësisë së Madhe, që shkëlqente. Kjo ishte surpriza e parë, e kësaj dite të shënuar për mua. Surpriza e dytë ishte kultura muzikore, ku binte në sy veçanërisht, një vegël muzikore tipike e kësaj treve - Lahuta, me këngë majëkrahut, siç i thonë vendasit, ku këngëtarët e këtij zhanri, ia prisnin me zë të lartë njëri-tjetrit. Por surpriza më e këndshme për mua, në atë dasmë, ka qenë ajo, kur vjehrra ime, Feride Gjonaj, një grua fisnike dhe e zgjuar, e cila nuk jeton më, më hoqi vëllon dhe më veshi Xhubletën e Famshme të Kelmendit. Ky moment, ka qenë kulmor për mua, ka qenë një çast tepër i gëzueshëm dhe emocionues, që më befusoi pa masë..., aq sa kur e pashë veten në pasqyrë, mu duk krejt ndryshe...! Ishte hera e parë, që e shikoja në trupin tim

një veshje të tillë, me vlera të jashtëzakonshme historiko - kulturore. Ndaj e përqafova me shumë, dashuri vjehrrën time Feride Gjonaj, të cilën e kam dashur aq shumë, si të ishte nëna ime biologjike. Ruaj kujtimet e mbresat më të mira prej saj, pasi ajo ishte një grua dinjitoze dhe me vlera njerëzore. Pasi veshja xhubletën, erdhi dhe surpriza tjetër e radhës, në këtë dasmë, në Reç të Malësisë së Madhe, që ishte dalja ime para dasmorëve me veshjen e bukur të xhubletës. Sapo kam dalë në oborr, dasmorët filluan të këndonin përsëri këngën: "Sa e bukur na ka dalë nusja...". Veç këngës, aty kam dëgjuar nga dasmorët edhe fjalët: "Mos ia hiqni më xhubletën! Le ta mbajë për gjithë jetën, sepse i përshtatet shumë! Dikush tjetër thoshte: U bënë dy bukuritë bashkë (nusja e bukur dhe xhubleta e bukur)...!" Ai çast me xhubletë ka mbetur i ngulitur në kujtesën time, por më mbeti merak, sepse nuk patëm fotograf për ta mbajtur si kujtim të veçantë të ditës së dasmës time. E megjithatë, kam vendosur, që kur të shkoj me pushime në Koplik, do ta vesh sërish xhubletën dhe do të realizoj edhe fotot e bukura, që dëshiroj.

## JETA BASHKËSHORTORE NË KOPLIK DHE EMIGRIMI NË ITALI

Pas dasmës, për mua dhe për Idrizin, thotë Vera, nisi një jetë e re. Të dy ne bashkëshortët filluam punë në Koplik, ku Idrizi punonte kryezooteknik dhe unë kryellogaritare. Më pas, ne u larguam nga fshati Reç dhe u vendosëm me banim në Koplik, ku jetuam për rreth dhjetë vite me radhë. Aty linda edhe dy djemtë: Veridjoni dhe Rezarjani. Jeta jonë në Koplik, ka qenë e mirë dhe unë ruaj kujtime të mira nga ai vend. Ne si çift, kemi kaluar shumë mirë dhe kemi pasur marrëdhënie shumë të mira edhe me banorët e bashkësisë së Koplikut. Unë dhe Idrizi, ishim të përkushtuar ndaj punës e profesionit, por me ndërrimin e sistemit, u mbyllën ndërmarrjet, shumë njerëz mbetën pa punë dhe kushtet ekonomike në çdo familje u vështirësuan. Kjo situatë preku edhe familjen tonë. Ngjarjet e trazirave të 97-tës, sollën një kaos të vërtetë, ku shteti ra dhe siguria për jetën, nuk funksiononte, pasi rendin e komandonin bandat dhe grupet mafioze të rrugës. Në këto kushte, ne si familje vendosëm të emigronim në Itali. Fillimi ka qenë tejet i vështirë për emigrantët, që keqtrajtoheshin, sepse pas ngjarjeve të 97-tës, ishte krijuar një opinion tepër negativ për shqiptarët. Kështu, që ne si familje, na u desh të përballonim shumë sfida, për të siguruar punë dhe kushte jetese. Por, merakun më i madh ishte edukimi dhe shkollimi i dy djemve, që ata të mos e harronin gjuhën shqipe, të donin vendlindjen, Atdheun dhe njerëzit tanë të gjakut. Dhe me sakrificë, ne si prindër ia dolëm me sukses. Ndaj sot ne kemi arritur të shkollojmë me të lartën të dy djemtë tanë, të cilët janë përshtatur mjaft mirë

me bashkësinë italian dhe gëzojnë respektin e tyre. Të dy djemtë janë martuar dhe ne kemi bërë dy dasma të bukura një në Itali dhe një në Kopluk, ku kanë lindur. Djali i madh, Veridjoni, 33 vjeç është martuar me një vajzë italiane, e cila është një nuse e mrekullueshme dhe është përshtatur mjaft mirë me familjen tonë, e donë Koplukun, e donë Shqipërinë, e donë Atdheun tonë dhe e donë edhe gjuhën shqipe. Ndërsa djali i vogël, Rezarjani, 29 vjeç, është martuar me një vajzë shqiptare nga fshati Reç i Sipërm i Malësisë së Madhe dhe ka një vajzë shumë simpatike, që quhet Veralda Gjonaj, e cila është 7 vjeç. Unë thotë Vera Gjonaj, në tregimin e saj, e dua shumë Veraldën, sepse ajo më ka dhënë për herë të parë, statusin e gjyshes në familjen tonë.

## JETA NË EMIGRACION E POETES

VERA GJONAJ

Duke qenë një grua me kulturë të gjerë profesionale dhe me pastërti shpirtërore, me nivel të lartë dhe me aftësi drejtuese, Vera Gjonaj prej vitesh, ka hyrë në botën e virtyteve, sepse jeta e virtyteve, të do të mençur, të matur dhe të guximshme. Vera ka investuar shumë në rrugën e dijes, ku secili prej nesh, duhet të jetë vetvetja, ndaj e çmoj dhe e vlerësoj këtë intelektuale, me vlera të veçanta në Shqipëri dhe në Diasporë. Zoti i ka falur asaj, bukurinë fizike, por me aftësitë e veta, me sakrificat dhe me përkushtim në shkollim dhe në punë, Vera ka lartësuar ndër vite edhe bukurinë shpirtërore, të cilën unë e shikoj në sytë e saj, që janë dritarja e shpirtit, janë fisnikëria, çiltërsia dhe pastërtia shpirtërore e njeriut të mirë...! Asaj i ka lezet fjala, i ka hije vargu e poezia, i shkëlqen si diell mendimi dhe zgjuarsia, e cila me urtinë e saj të trashëguar prindërore, afirmon kudo vlerat e femrës dinjitoze shqiptare. Dhe kjo është një krenari kombëtare, jo vetëm për Verën, por dhe për të gjithë shqiptarinë, brenda e jashtë vendit...! E themi këtë, pasi poetja Vera Gjonaj, që nga viti 2000, për një çerek shekulli, jeton e banon bashkë me familjen e saj në Itali, ku ka ndërthur një profil të fuqishëm, si aktiviste kulturore, krijuese letrare dhe mbrojtëse e të drejtave të njeriut. Ajo mban titullin e "Ambasadores së Paqes Botërore", si dhe është e angazhuar si misionare, në pajtimin e gjaqeve - një mision me rëndësi të jashtëzakonshme, që ajo e ka të trashëguar si amanet nga babai i saj fisnik, Musli Etemi, që nuk jeton më. Ndaj, në çdo bisedë, sa herë e përmend babë Musliun, ajo emocionohet dhe thotë: "Unë jetoj për babain tim, që e kam idhull në jetë. Para tij, jam betuar qysh kur isha fëmijë, se do t'ia shtoj krenarinë dhe dinjitetin dhe këtë premtim, do ta mbaj gjithë jetën time. Ndaj, sa herë shkoj tek varri i tij, dialogoj metaforikisht me të, duke i thënë: "A ke ndonjë porosi për mua babë? A ta kam mbajtur fjalën? Pusho i qetë baba, se amanetet tuaja, unë nuk i harroj kurrë...!"

Shpirti human i intelektualës së njohur të Diasporës - Vera Gjonaj, shprehet edhe në ruajtjen e harmonisë sociale dhe



të vlerave njerëzore në bashkësinë shqiptare, brenda dhe jashtë Atdheut, duke treguar modelin e një gruaje fisnike e të ditur, që i duhet vendit dhe shoqërisë. Duke parë tek Vera Gjonaj, një femër të zgjuar e të ditur dhe me shumë kontribute, që di t'ia bluaj mirë mendimet, që ka një linjë të saktë arsyetimi, që flet pak dhe punon shumë, atë e kanë vlerësuar vazhdimisht edhe në Diasporë, duke i dhënë asaj, vende pune të rëndësishme, të cilat ajo i ka mbajtur me aftësi e përkushtim, duke afirmuar dukshëm vlerat e veta intelektuale e drejtuese, në çdo punë, që i është besuar. Zgjuarsinë e saj, ajo e shpreh në aftësitë e veta intelektuale, në kapacitet drejtuese e organizuese, në korrektesinë, në angazhimin dhe në përgjegjshmërinë, që e karakterizon gjithnjë, në realizimin e detyrave të ngarkuara.

Zj. Vera Gjonaj është kryeredaktore e Gazetës "Albania Press", si dhe anëtare aktive e Klubit Letrar të Poetëve, Shkrimtarëve dhe Artistëve të Veriut, përveç shumë shoqatave dhe revistave kulturore, ku ajo kontribuon rregullisht me artikuj, poezi dhe ese të pasura, në përmbajtje dhe në mesazhe. Ajo ka organizuar dhe ka marrë pjesë në dhjetëra aktivitete kulturore e promovime letrare, në vende të ndryshme, duke përfaqësuar me dinjitet

kulturën, artin dhe fjalën shqipe, në arenën ndërkombëtare. Ajo, gjithmonë ka ecur me hap të matur dhe jo të nxituar, ka ecur gjithmonë me këmbë në tokë. Deri më sot, ajo ka botuar gjashtë libra, të cilët janë mirëpritur nga lexuesit dhe kritika letrare, për stilin e saj të ndjeshëm dhe elegant, për tematikën humaniste dhe përkushtimin në pasurimin e letërsisë shqipe bashkëkohore. Ndërkohë, Vera po punon për përgatitjen për botim edhe të librit të shtatë të saj, me poezi. Veprat e saj përfshijnë titujt: "Mall Largësisë", "Princesha e Gjyshes", "Ëndrrat e Veraldës", "Rrënjët dhe stuhi", "Në Flatrat e Mallit", si dhe "Përse e Dua". Krijimtaria e saj është një thirrje për paqe, është dashuri dhe kujtesë kulturore, e cila lartëson identitetin shqiptar në diasporë dhe frymëzon brezat e rinj, për të ruajtur gjuhën, traditat dhe trashëgiminë e Kombit tonë. Ajo është gjithashtu promotore e shumë bashkëpunimeve, mes autorëve të rinj shqiptarë dhe botuesve, duke ofruar mbështetje për afirmimin e zërave të rinj në letërsinë shqipe.

Përmes Gazetës "Albania Press", ku është kryeredaktore, Vera Gjonaj ka hapur një dritare të rëndësishme, për kulturën dhe krijimtarinë e shqiptarëve në mërgatë. Gjithashtu, duke qenë edhe

drejtoreshë e një Radio Shqip on line, në Suedi, që mban emrin "Minatori", Vera ka kontribuar shumë, në forcimin e marrëdhënieve në mes shqiptarëve të Diasporës, si dhe ka rritur prestigjin dhe emrin e mirë të emigrantëve shqiptarë, kudo në botë. Veprimtaria kulturore e Zj. GJONAJ, nuk është thjeshtë një angazhim personal, por një mision i vjueshëm, në shërbim të bashkësisë dhe të vlerave, që i japin shpirt dhe integritet një Kombi në arenën ndërkombëtare, siç janë: fjala, arti, dashuria për identitetin kombëtar, e të tjera. Vera, në shkrimet e saj të publikuara, ka derdhur në to, gjithë pasuritë e botës mendore dhe të shpirtit të vet poetik, ku fjalët i dalin rrjedhshëm, si një lumë kristalesh me shumë peshë, të cilat këndojnë, ndejnë, pulsojnë e frymojnë dhe ngrihen deri në qell, ku valëzojnë me yjet dhe vijnë tek ne, më të ndriçuara, më të bukura, sepse ato (fjalët) flasin me gjuhën e atdhetarisë e të patriotizmit shqiptar, flasin për krenarinë tonë kombëtare, flasin për historinë e lashtë e të lavdishme të Kombit Shqiptar...! Dhe poetja Vera Gjonaj, flet me këtë gjuhë, sepse ajo e ngjyen penën, në gjakun e zemrës, për të treguar se gjaku është jetë, është identitet, është histori dhe trashëgimi vlerash, që përcillet me dashuri ndër breza. Pra, në shkrimet e saj, Vera ka vulosur shpirtin e vet, të cilin lexuesi e ndjen, në çdo germë e në çdo fjalë, që del si një ujëvarë e kristaltë, nga shpirti behar dhe mendimi diellor, që rrezaton Frymëzim e dashuri për Kombin dhe për Shqiptarinë...! Me shkrimet dhe me krijimtarinë e saj, Vera Gjonaj, nxit dhe kultivon tek brezat e rinj, dashurinë për librin dhe dashurinë për leximin, duke jua bërë të qartë atyre, se libri është esenca e kulturës dhe e dijes, që nuk e humb vlerën e tij asnjëherë. Me këtë mesazh, ajo kërkon nga të rinjtë, që t'ia përkushtohen me më shumë dashuri leximit, të duan fort librin dhe të mos jetojnë kulturën e "boshit", duke u dhënë pafund pas dixhitalizimit.

Ky është profili i poetes dhe prozatores së talentuar Vera Gjonaj, e cila duke qenë kryeredaktore e një gazete prestigjioze, siç është "AlbaniaPres.com" në Itali, ka luajtur një rol të rëndësishëm, në përcjelljen e shumë mesazheve me vlera kombëtare, ka ndikuar në bashkimin e poetëve shqiptarë, duke i frymëzuar e nxitur ata, që të ecin pas dritës, e cila mbron dhe publikon vlerat dhe historinë e kulturës tonë identitare të Kombit Shqiptar, si kombi më i lashtë autokton i Kontinentit. Në këtë kuptim, kontributi i Vera Gjonajt, si kryeredaktore, në mbrojtjen e gjuhës, të historisë, të traditave e të trashëgimisë tonë kulturore, nga lashtësia e kohës së ilirëve, e deri në ditët e sotme, merr një vlerë të madhe e të veçantë, që rrezaton atdhetarizëm dhe frymë kombëtare, brenda e jashtë Shqipërisë, në Diasporë dhe kudo tjetër, ku jetojnë e banojnë shqiptarët.

Urime dhe suksese shqiptares fisnike të Diasporës Vera Gjonaj!

Tiranë, më: 16 shtator 2025

# Lexim filozofik i poezisë së Kumrie Avdyl Shalës

Poezia "Riga-riga gjak shpirti pikon" e Kumrie Avdyl Shalës, nga libri me poezi "Gjëmë e nëm lirie", është një akt poetik i dhimbjes dhe i rezistencës. Ajo shpalos ankthin kolektiv, një tragjedi të trupëzuar në metafora e simbole që e shndërrojnë tekstin në klithmë ekzistenciale dhe politike. Nuk kemi të bëjmë thjesht me një poezi intime, por me një testament shpirtëror që pasqyron fatin e një populli të nëpërkëmbur.

Gjaku i shpirtit – dhimbja e padukshme

Në qendër të poezisë qëndron metafora e fuqishme "shpirti gjak pikon". Ky gjak nuk është trupor, por shpirtëror, duke treguar se plagët më të rënda janë ato të brendshme: humbja e dinjitetit, e lirisë dhe e shpresës. Nietzsche do të thoshte se "Ai që ka një arsye për të jetuar mund të durojë pothuajse çdo gjë". Ky mendim mund të shërbejë si argument, se dhimbja mund të përballohet kur ka një kuptim, por këtu dhimbja është pa kuptim, një plagë që vetëm rrjedh e nuk shërohet. Pikërisht për këtë arsye ajo shndërrohet në thirrje për drejtësi dhe rezistencë.

Çizma – simboli i barbarisë

Figura e "çizmes" përfaqëson pushtetin e verbër dhe dhunën e institucionalizuar. Ajo marshon pa shpirt, pa ngjyra, pa ndjenja. Sartre do të thoshte se kjo është fytyra e "tjetrit" që e zhvesh njeriun nga liria dhe e redukton në objekt. Ai shumë mirë argumenton se "Kur shohim një person tjetër, automatikisht e shohim si 'Tjetrin'. Kjo e redukton atë në një objekt dhe, në të njëjtën kohë, kufizon lirinë e tij."

Ritmi i përsëritur "një, dy, tre" e kthen poezinë në një skenë makabre ku individi bëhet viktimë e një mekanizmi shtypës që ecën pa ndalur. Çizma nuk është vetëm simbol politik, por një metaforë ekzistenciale e njeriut të robëruar.

Ishulli pa emër – horizonti i lirisë

Përballë barbarisë, poetja krijon një figurë të kundërt: "Ishulli pa emër". Ai është një vend i utopisë, një horizont ku shpirti kërkon strehë, gjak të ri dhe liri. Por mungesa e emrit e bën ishullin të paarrtshëm. Camus, në Mitin e Sizifit flet për absurditetin e jetës së njeriut: dëshira për kuptim në një botë pa kuptim. Ai thotë: "Njeriu qëndron ballë për ballë me irracionalen. Ai ndien brenda tij dëshirën për lumturi dhe për arsyen. Absurdi lind nga kjo përballje". Ishulli pa emër është pikërisht ky absurditet: Një shpresë që shihet, por nuk kapet, një horizont që gjithmonë largohet.

Mallkimi si akt rezistence

Kur njeriu s'ka armë, fjala shndërrohet në mallkim. Poezia mbushet me gjëmë e nëmë, duke i kthyer emocionet në akt rezistence. Kjo është ajo që Ortega y Gasset do ta quante "rebelim i masës së shtypur", ku fjala dhe mallkimi bëhen armët e fundit të dinjitetit. Ortega y Gasset thotë: "Masat e shtypura nuk kanë asgjë tjetër përveçse mallkimin e tyre". Mallkimi nuk është dorëzim, por një shenjë se shpirti nuk pranon të heshtë. "Fara ime e zezë" është damka që poeti ia lë pushtuesit, si kujtesë e përrjeshme e dhunës së kryer.

Liria në dry – tragjedia e ekzistencës

Kulmin e mesazhit e gjejmë në vargjet e fundit: "Nën çizmen tënde, liria rri në dry". Këtu shfaqet tragjedia ekzistenciale: liria ekziston, por është e burgosur. Sartre do të thoshte se njeriu "... është i dënuar të jetë i lirë", por kjo poezi e kthen këtë paradoks në realitet të dhimbshëm: Liria është aty, por prangoset, mbyllet në dry. Sartre argumenton se "Njeriu është i dënuar të jetë i lirë". Ky është absurditeti i jetës së shtypur – një jetë ku liria është gjithmonë e pranishme, por e mohuar.



"Riga-riga gjak shpirti pikon", është poezi që kapërcen kufijtë e artit për t'u bërë dëshmi filozofike dhe historike. Ajo flet për plagët e shpirtit të robëruar, për dhunën që marshon si çizme e verbër, dhe për lirinë që mbetet horizont i paarrtshëm. Në këtë poezi, Nietzsche, Camus dhe Sartre mund të lexohen së bashku: Njeriu i shkelur nga absurdi, i zhveshur nga dinjiteti, por që nuk heq dorë nga shpresa dhe rezistenca.

Shala e kthen poezinë në një testament shpirtëror: Liria mund të jetë në dry, por gjaku i shpirtit nuk ndalet, dhe derisa ky gjak të rrjedhë, liria nuk do të shuhet kurrë.

## RIGA-RIGA GJAK SHPIRTI PIKON

Fshehurazi e pa zë shkele damarët e shpirtit tim,  
Shpirti gjak pikon,  
Riga-riga për së kthjellëti.

Ti nuk ke parë gjak shpirti kurrë,  
As çizma jote nuk merr vesh nga ngjyrat,  
Ti dhe çizma jote njëlloj jeni.

Do të shkosh tash pas shpirtit tim,  
Të arratur në një ishull pa emër,  
Vetëm mallkimi i tij ka emër,  
Ashtu si ka numër çizma jote.

Një, dy, tre...  
Marshi i mallkimit prapa shpirtit tim shkon,  
Një, dy, tre...  
Edhe marshi i mallkimit tim i shkon prapa,  
Radhë pa fund e kësaj ushtrie tmerri.

Një, dy, tre...  
Më parë sesa marshi i çizmes sate,  
Ti ke arritur, po ishulli ka shkuar më tutje,  
T'i gjejë qetësi shpirtit,  
T'i japë gjak,  
T'i japë liri.


Vetëm plagët kthehen  
Nga ajo rrugë pa fund e pa emër,  
Kthehen,  
Shtohen,  
Nuk shërohen.

Më parë sesa plagët,  
Kanë arritur gjëma dhe nëma ime,  
Të bien ty, fara ime e zezë!

Një, dy, tre...  
Por buzëqeshja e lirisë nuk marshon,  
Është ngrirë si ai gjaku poshtë çizmes sate,  
Lëshon gjëma e nëma,  
Si kur gjëmon e nëm nënëlokja që të jep gji,

Po ti nuk ke parë gjak me sy,  
Nën çizmen tënde,  
Liria rri në dry.  
Nga libri "Gjëmë e nëm lirie" i autores Kymrie Shala

Nga Dr. AGON HALABAKU



## SUMË - EMËM I LINDUN PREJ MAJAVE

(Ese etimologjike)

Etimologjia e emnit Sumë lidhet me latinishten e vjetër, prej fjalës (summa), qi don me thanë maja, kulm, lartësi. Ky kuptim i hershëm i përket natyrshëm vendit: një fshat i ngritur n'kresha, ku qielli prekë tokën e ku horizonti duket pa cak.

Por në gegnishten popullore, fjala Sumë ka pasë edhe kuptimin "shumë, mjaft". Kështu emni i fshatit mori edhe një dritë

tjetër: vend i begatshëm, tokë me prodhime, njerëz të bujarë.

Sa për kuptimin banal qi ka marrë fjala në zhargonin e vonë, ai s'ka lidhje me këtë toponim. Sumë nuk asht shaká e tavolinash, por një thesar i lashtë gjuhësor, i trashëguem prej shekujsh.

Prandaj, ky emën duhet me u lexue me seriozitetin e vet të vjetër: si kulm e si bollëk njëherësh, si kujtim i majave ku ka

lindë e u rritë një vendbanim, e si shenjë e pasunisë së gjuhës shqipe.

E nëse fshati do t'kishte gojë, do t'thoshte: "Unë jam Sumë, maja ku lind bollëku, e bollëku ku ngrihet maja." Suma antike e vjetër si toponim pse jo dhe vendbanim, që përkon qe me epokën romake

## SHQIPTARËT TË PRIVILEGJUARIT E BABA DULETT



(Ku ishin shqiptarët më të privilegjuar?)

Shumë shqiptarë arritën deri në vezirë të mëdhenj, pashallarë, guvernatorë, madje edhe në fron sulltanësh-Kryeministra (nëpërmjet haremeve). Shqipëria u bë "burim i jeniçerëve" – shumë djem të marrë me dëshirë u ngjitën në poste të larta, si Koxha Sinan Pasha, Mehmet Pashë Bushatliu, Ali Pashë Tepelena. Shqiptarët myslimanë, ndryshe nga serbët, grekët apo bullgarët ortodoksë, nuk ishin popull i nënshtruar fetarisht. Ata gëzonin barazi dhe shpesh privilegje si pjesë e "milletit islam". Në shumë zona malore (Malësia e Madhe, Dukagjin, Labëri), osmanët e lanë popullin me vetëqeverisje sipas kanunit. Bajrakët nuk paguanin gjithmonë taksa të plota, mjaftonte të dërgonin luftëtarë në

kohë lufte. Shqipëria ishte urë midis Stambollit dhe Italisë. Për këtë arsye Porta e Lartë mendohej t'i mbante shqiptarët afër dhe t'i përdorte si ushtarë besnikë.

### Kush nuk ishin shqiptarët më të privilegjuar?

Ndryshe nga grekët (me Patriarkanën e Kostandinopojës) apo sllavët (me kishat e tyre), shqiptarëve nuk iu lejua shkolla në gjuhën amtare deri shumë vonë. U la populli analfabet, pa libra shqip, pa institucione kulturore. Bejlerët, agallarët e bajraktarët nuk përfaqësonin kombin, por interesat e tyre. Shqiptarët nuk patën një këshill kombëtar si serbët apo grekët, të cilët krijuan struktura të hershme çlirimtare. Kur shqiptarët kërkonin autonomi

kombëtare (jo thjesht privilegje), osmanët i shtypnin ashpër (p.sh. Lidhja e Prizrenit, 1881).

Pra, privilegjet vlenin sa kohë ishte ushtar i sulltanit, jo kur kërkoje Shqipëri. Po, shqiptarët ishin më të privilegjuar se fqinjët e tyre ballkanas në aspektin ushtarak e politik, sepse shpesh i shërbenin si shtyllë Sulltanit. Por, në të njëjtën kohë, ishin më të diskriminuar në aspektin kulturor dhe kombëtar: nuk patën shkollë, gjuhë, kler të bashkuar, institucione kombëtare.

Kjo është arsyeja pse shqiptarët u ngritën të fundit për pavarësi: kishin pushtet brenda Perandorisë, por nuk kishin një shtet e kulturë të vetën.

### Shqiptarët në Perandorinë Osmane – mes privilegjeve dhe ëndrrës për liri

Shqiptarët shpesh ishin më të besuarit e Sulltanit: dhanë shumë vezirë të mëdhenj (si Mehmed Pashë Sokoloviçi, Koca Sinan Pasha, e të tjerë), dhanë shumë jeniçerë, spahinj dhe ushtarakë elitë, ishin të pranishëm në administratë e diplomaci. Në krahasim me serbë, bullgarë e grekë, shqiptarët shpesh kishin më pak kufizime për t'u ngjitur në hierarki, sidomos nëse kalonin në islam. Po aq sa shërbenin Portës, shqiptarët ishin të njohur për kryengritje të shpeshta (Kryengritjet e Malësisë, Lidhja e Prizrenit, e të tjera). Në Perandori



Poeti, studiuesi e publicisti  
**PRELE MILANI**

shpesh trajtoheshin si luftëtarë të zotë, por edhe si të rrezikshëm e të pabindur. Kjo u solli një status të veçantë: respekt të frikshëm, por jo gjithmonë besim të plotë. Ndërkohë që grekët, serbët e bullgarët u çliruan më herët, shqiptarët mbetën më gjatë nën Perandori sepse: Shqiptarët ishin të ndarë fetarisht (myslimanë, katolikë, ortodoksë) një pjesë e elitës shqiptare përfitoi nga Porta dhe nuk kërkoj pavarësi menjëherë mungoi një shtet i centralizuar, vetëm Lidhjet dhe kryengritjet krahinore mbajtën gjallë ndjenjën kombëtare.

### Pasoja historike

Shqiptarët u gëzuan privilegjeve të shërbimit në Perandori, por vonuan shtetin e tyre. U ndodhën të fundit në Ballkan që shpallën pavarësinë (me 28 nëntor 1912), edhe pse kishin qenë mes popujve më luftarakë e më të pranishëm në Perandori. Pra, shqiptarët ishin më të privilegjuar se shumë ballkanas brenda Perandorisë, por ky privilegj solli edhe një "kurth": e shtyu në kohë çlirimin kombëtar.

## PENGU I TRAKTORISTIT DHE TAKAT E KUQE T'VEJUSHËS

(Esse nostalgjike)

Ishte një ditë e kthjellët tetori. Qielli pa re, dielli i butë si argjend, gjethet e para t'blinit zverdhnin tue ba mozaik me dritën e mbramjes, e fshati merrte frymë n'përgatitje feste. Asht datëlindja e shokut Enver – babës së madh të popullit e partisë. Skena e madhe nqendër të fshatit ishte stolisë me parulla, portrete e ngjyrë të kuqe sa për një vjeshtë të tanë.

Tabloja "Gju për gu me popullin" varej madhështore mbi tribunë, si për me na bindë se edhe ai vëzhgonte, edhe nëse s'kishte ardhë personalisht. Në mes t'ksaj hareje, koncertit i jepte hijeshi Mësuesja Irena Topi — bjondinë natyrale, trup gjatë, me një dantellë t'bardhë përmbi gjoksin e drejtë, këpucë t'kuqe me takë të nalta si shtiza ndë shelg. Së kishte humbë hijen as pas të pesëdhjetave. E qeshun, e stolisun me një lloj elegancë që nuk e fshihet as uniforma ideologjike.

Vejushë prej një viti — e kishte varrosë burrin, Refikun, poshtë blinit, me një shen-

jë të vogël në gur: Komunist i flakët, burrë i thjeshtë, pushon me nder. Pushonte ai, por jo mendja e Irenës. Mark Gila, nga ana tjetër, kishte marrë pjesë si përfaqësues i vullnetarëve të kooperativës. Kishte hedhë xhaketen mbi supe, e mbante një çibuk me tymin e hollë si trajneri i Italisë, Bearzot. Njeri me humor në gen, e gazi i tij të ngjitej si aromë supë n'mbramje të vjeshtës. Kur koncerti mbaroi, u takue me Irenën: — Mësuesja Irena, pse s'këndove atë këngë "Mësuesja dhe Traktoristi"? Ka qenë hit, mo! Tekst i Kadaresë vetë:

*U martue mësuesja me traktoristin,  
gëzoi krejt fshati socialist...*

S'ta mbajti?

Irena e fiku buzëqeshjen, por s'u tregue nguruse:

— Po, more Mark, por s'të vuna re që ishe aty. Mbase duhej me t'përsëndetë me atë këngë. Ti ishe traktoristi i vërtetë, por s'ishte koha... Je martue herët.

— Besa, faji s'ishte i jemi. Më dhanë nuse me rekomandim, gjyshi u konsultue

me Sekretarin e Partisë. Ndërsa mësuesja që i pëlqente traktoristit, përfundoi nuse e kryetarit të Këshillit. Kadareja e nxori mirë n'këngë, por na e prishi realitetin. Unë mbeta me peng, ajo me kurorë.

— Edhe peng, more Mark, asht i jetës. S'ke gene i vetmi. E traktoristi, sado i zoti me punë, nuk ka qenë gjithmonë i zoti me gra...

— Ma thuaj n'këtë moment se m'vrave! — tha Marku tue qeshë.

— E tashti që t'i ke heqë rrobat e zisë, e ke hjekë edhe flakën e partishmënisë prej shtatullash, hajde ndreqim këngën. Kthehu te traktoristi yt i moçëm. Le ta marrim një Nobel për dashni t'pakëndueme e Kadarenë e bajmë nuse n'letra.

— Mark... traktorin tand e kam pa gjithmonë me respekt, por s'mundem me hyp në të. E ndjej Refikun që më sheh nga varri, nën blin.

— E moj e mirë, Refiku nuk pa as kur ishte gjallë, jo më tash i shtrime me sy për-pjetë! Po s'po të thom me marrë trakto-

rin e me lëshu fushë, thjesht ndreqim një refren, pa lot e pa peng. Po i mbeti peng Refikut, do t'ia këndoje një këngë më vete: "Vejusha me takat e kuqe n'mendje më ka mbetë."

Irena qeshi, u kthye me dritë në sy, por zani iu randue pak:— Mark... ke shpirt artisti. Por nuk mundem me i ikë hijes së një njeriu që më ka dashtë. Nuk asht frikë, asht ndjesi. Unë e ndjej që më sheh. E kur dikush të sheh prej përtej, traktorin e shikon si karrocë shpirtnash, jo si mjet lirie...

Marku e pa me butësi. E shkrepri edhe një herë çibukun dhe tha:— A do me të thanë se dashnia jeme u mbulue me gjethe blini para se me lëshue lule?

— Jo, more Mark. Dashnia jote kurrë s'ka pas nevojë me u mbulue. Ajo veç vnoi me ardhë.

—Qeshi dita, e u mbyll me një vals të heshtun ndërmjet një dashnie që u këndue veç n'refren e një pengu që nuk u lirue kurrë.

# Poezia e ndërlikuar e Camajt, që nuk u shkëput kurrë nga filli i vendlindjes



Nga Gjon Marku

Martin Camaj vlerësohet si njëri ndër krijuesit më të veçantë në letërsinë dhe kulturën shqiptare. Poet dhe prozator, studiues, filolog dhe gjuhëtar i formimit akademik. Vështirë të gjendet një tjetër krijues që si Camaj të ketë prodhimtari dhe shkëlqim në krijimtarinë e mirëfilltë letraro-artistike dhe në punën kërkimoro-studimore, që të ketë një individualitet krijues të spikatur dhe të veçantë, apo që të mitozojë dhe ndërtojë e rindërtojë me një origjinalitet artistik të spikatur dhe me një pasuri të rrallë stilistikore atdheun e munguar, natyrën, malin dhe kodin e tij të munguar, mitet dhe legendat dhe traditat, të cilat gjithnjë e gjithherë vijnë për lexuesin e huaj.

Së pari, sepse ai vendit të vet i ishte ndaluar e së fundmi dhe për lexuesin shqiptar me një visar të pasur leksikor prej maleve të vendlindjes, ku traditat, njerëzit dhe kodet e jetesës dhe mbijetesës marrin jetë në një mjedis të ishulluar tradicional dhe të papërsëritshëm.

Ai identifikohet me tokën e vet edhe si territor edhe si mjet prodhimi. Toka, vathi, mrizi, stani, delja, dhia, ara, lumi, qielli, ajri, reja, mali janë koordinatat prej nga buron e rrjedh jeta e tij fizike, mendore dhe shpirtërore.

“Ai nuk mund të jetojë kurrkund tjetër veç aty,” -shkruan Primo Shllaku. “Burri i malësisë ndër gurra shtiret si me i pas lanë diçka mangu kësaj jete, kinse i flijuem me vete për të mbarë të familjes”.<sup>(1)</sup>

Camaj në mënyrë jo rastësore shpesh e ndërlikon paraqitjen e vepërës së vet, e kjo e lidhur me njohjen dhe kulturën e tij, duke e gdhendur me kujdes çdo frazë dhe fjalë, duke i dhënë peshë mendimit dhe fjalës që gjithnjë është në funksion me sistemin e vlerave dhe të realizimit artistik.

Edhe pse me atdhe të ndaluar e me një ndarje hermetike nga lexuesi i vendit të vet, e pati privilegjin të mund të shkruante drejtpërsëdrejti në gjuhët e mëdha të kulturës evropiane, por asnjëherë jashtë gjuhës dhe pasurisë së saj të vendit prej nga vjen. Ai e njeh mirë traditën shkrimore paraardhëse të vendit tonë, i ndërjegjshëm e rrënjës fort gjuhën e pasur të këtij vendi dhe si lëvruet i shquar e mbi të gjitha si studiues, e tejkalon dhe pasuron atë, e ngre në nivele të reja me një forcë artistike marramendëse.

Në fakt kur lexon me vëmendje Camajn ndërmend vetëtimthi të vjen Fabian Barcata, një tjetër shkrimtar, dhe pse jo shqiptar, i cili aty në kepin e bardhë të Kishës së Rubikut shkruan: “Orët, kur më zë malli për vendlindjen”. E duket se krijimtarinë e Camajt, sidomos atë poetike, e ka të ngërthyer nga “Orët, kur e zë malli për vendlindjen”.

Frika e humbjes së vendlindjes shpesh e bën atë të mendojë frikën e humbjes së vetvetes, prandaj ai iu kthehet e u rikthehet këtij malli për vendlindjen, këtyre miteve dhe këtyre njerëzve, këtyre ndjesive, këtyre ideve dhe kësaj fryme. Camaj shkruan:

*“Nata e vetmia plastë,  
mbi malin e thatë,  
mbi andrrën e keqe!  
E liga ndër leqe!”<sup>(2)</sup>*

Primo Shllaku në librin “Një Ulik që s’mbërriti kurrë në Itakë”, (Atë Gjergj Fishta, Lezhë 2006, fq. 82), shkruan: “Ai kishte interes me ardhë, ardhja në vendlindje ishte diçka si uja që kishte ndie në fëmijërinë e vet e që asgja s’mund ta fashiste pos hapjes së tij para lexuesit shqiptar”<sup>(3)</sup>. Camaj me së miri këtë dëshirë për kthim e përshkruan vetë dhe na e jep ne të qartë mendimin e tij kur pohon:

*“Para se të mbylleshin sytë në gjumë,  
pashë malin e akullit të bardhë,  
te kambët e mija  
Ai mal akulli kishte një emën,  
një emën tabu”.<sup>(4)</sup>*

Prandaj poezia e tij me të drejtë, siç shkruan Arshi Pipa, i sillet rreth asaj të humusit të vet kulturor,<sup>(5)</sup> (Arshi Pipa, Poezia dhe poetika e Camajt), gdhendur me privilegjin dhe mundësitë e mëdha shprehëse që të jep gjuha shqipe e mbi të gjitha, pa u larguar nga tërësia etnokulturore shqiptare, pa u larguar nga mitet, nga ndijimet e hershme, nga fëmijëria dhe bota virtuale e fantazmambushur e rrëfjave, miteve, legendave, nga historia, nga natyra e veçantë e maleve të Veriut dhe kodeve gati mitike, edhe pse jeton në zemër të Evropës jashtë kodit dhe mitit të maleve nga vjen. Por kjo e fundit e ndihmon fuqishëm atë të arrijë në mendimin e tij të stërholluar e të mirëlatuar intelektual, duke na bërë të qartë se kemi të bëjmë me një intelektual tejet të kulturuar e të qytetëruar, por të patjetërsuar nga të jetuarit e gjatë jashtë vendit të vet në perëndim. Me mjeshtërinë e një poeti të lindur e modern e shumë i vetëdijshëm, përdor mjetet shprehëse tradicionale duke i vendosur ato në realitetin e vendlindjes, por duke tejkaluar shumëfish poezinë tradicionale.

Prandaj Alpet e Veriut, vendlindja, mitet, vegimet, bota virtuale e fantazmambushur e rrëfjave, legendave, ndijimet e hershme janë malli i etnisë prej nga vjen

Camaj.

“Prania e autenticitetit shqiptar në poezinë e tij dhe e poezisë së tij në letërsinë shqipe kanë mbetur gjithnjë një prani e mosprani, si kujtimi i gjallë, bashkë me ëndrrën e tij për kthim”, shkruan Sabri Hamiti.<sup>(6)</sup> Ky mall e kjo vetëdije krijuese, siguri dhe besim në vetvete vijnë më së miri në pohimin e vetë Camajt.

“Në vëllimin poetik “Legjenda” përtpa në mend aso tregimesh e vargjeshe popullore që dëgjova para shumë vjetësh: “Janë ngjarje shpesh gojëdhënash, prandaj i quajta legjenda.”<sup>(7)</sup>

Në parathënien e librit; “Një fyell ndër male” në Kangën e Vërrinit, të pabotueme, dorëshkrime, variante”, botimet “Camaj –Vepra” ,vëllimi 9-të, Tiranë 2010, fq. 10 -11, Dhurata Shehri pohon se: “Camaj gabimisht receptohet sot si tradicionalist, por ai është larguar nga tradita dalëngadalë e shumëfish, që nga vëllimi i Kangës së Vërrinit e deri te cikli i dorëshkrimeve të fundit.”<sup>(8)</sup>

Në fakt, vetë Camaj, shkruan: “Poezia ime i ka rrënjët në ato rrethana jete të cilat unë dua që të mbahen mend. Që, p.sh.: “Unë kam lindë në një vend të egër ku nuk ka shkel ndonjëherë kamba e kalit, kaq i thyem ashtë terreni”. Martin Camaj, në parathënie të botimit anglisht të vëllimit “Palimpsest”, cilësohet sipas përkthimit të Primo Shllakut “Një Ulik që s’mbërriti kurrë në Itakë”.<sup>(9)</sup>

Ma tej ai shprehet se: “...në tematikë jam ende i lidhur me shkëmbinjtë e mij: dëshiroj që edhe publiku i këtuhi ta ketë parasysh se unë flas dhe mendoj si dukagjinasi i Shqipnis”.<sup>(10)</sup>

Ai vend e mban atë të ngërthyer si në një udhëkryq e ato male prej nga vjen ai janë si shenjtër, për të pse aty janë rrënjët e të parëve ku lindin tradita të papërsëritshme e të stërlashta, por dukshëm shfaqet shqetësimi nëse ato ruhen prej nipërve dhe mbesave. Pa dashur që ato tradita të jenë pjesë e një izolimi të kahershëm, të cilën jo vetëm nuk e dëshiron dhe nuk e do, përkundrazi nipat dhe mbesat e veta i sheh të lidhur me qytetërimin e përparimin perëndimor, por të ardhur prej traditash të ruajtura mijëra vjet. Natyrisht nuk e lë jashtë vëmendjes, por me finesë trajton konfliktin që ka dhe ekziston mes brezash, por ky brez i ri ka diçka fisnike të trashëgueshme nga brezat e vjetër, diçka fisnike e të papërsëritshme për vlerën që ka, e me guxim ai pohon.

*“E sot djali em ashtë aspak si unë:  
din me folë ngjuhë të hueja,  
e para ‘i mijë vjetsh si ka ndodh  
çdo punë”.<sup>(11)</sup>*

E u bën thirrje nipërve me e ruejt fort të mirën e fisniken:

*“Lahuta pushon në tra,  
pse mixha ka dekë ka mot,  
e nipi s’din me i ra.”<sup>(12)</sup>*

“Për të krijuar një poezi origjinale ai para së gjithash shtegton brenda vetes. Endokozmosi ishte bota e tij” shkruan Prof. Dr. Shaban Sinani.<sup>(13)</sup>

Ai është i vetëdijshëm dhe e di mirë se kodet e maleve janë thyer, janë zbehur dhe nuk ka kush ti trashëgojë. “Është kjo ideologji e jetës së re, e thyerjes së kodit tradicional, për të dalë nga konvenca, që rregullon, por dhe që ndalon në rrugën e zgjedhjeve të shpirtit” shkruan Kujtim Shala.<sup>(14)</sup>

E kur Camaj sheh se kodet mitike po shuhet, dhimbja i shtohet me tepër e me kurajo, por dhe dhimbje, shkruan:

*Lamtumirë, o votër me thegjj të vjetër,  
lamtumirë, po të tham si votrës sëme,  
e dij se pa nderë s’lshove kurr mikun .  
Një dhimb’më shtove e s’due ma tjetër, ...*

O votër e fikun. (Martin Camaj “Një votër e fikun” në: “Kanga e Vërrinit”, botimet “Camaj” Vëllimi 9-të, Tiranë 2010, fq. 134.

Toka, vathi, mrizi, stani, delja, dhia, ara, lumi, qielli, ajri, reja, rrungaja, atdheu i munguar, natyra, mali dhe kodi i tij të munguar, mitet dhe legendat dhe traditat janë koordinatat prej nga buron e rrjedh jeta e tij fizike, mendore dhe shpirtërore.

“Ajo, që fillimisht është një poezi jehonash, e cila risjell në vetvete jehonat e vendit, sidomos në periudhën e parë të tij. “Një fyell ndër male”, “Kanga e Vërrinit” shndërrohen më pas në poezinë e qenies estetike, që botën e thelbësor, duke e shndërruar në vepër arti,” -shkruan Dhurata Shehri.<sup>(15)</sup>

E në letrën, që i dërgon Malokit, duket haptazi shqetësimi i tij për të pasur e përsosur poezinë e tij maksimalisht. “U lutem të m’i vini në dukje, kur të shihni se ka vetëm emocion pa ndoj art, kam përdor dhe fjalë, që s’gjenden ndër fjalorë, por të cilat përdoren në Dukagjin, a thue ashtë mirë me i spjegue ashtu si në poemë ose me i lanë lexuesi t’kuptojë si mban kontekstit”.<sup>(16)</sup>

Poezinë e Camajt, Arshi Pipa e vendos në radhë të parë me poezinë më të mirë evropiane.

Poezia e Camajt të afron shumanshmërinë e vet sidomos në ato poezi që kanë bjeshkë e mal, lis e drin, breshkë e gjarpër. “Janë ndër krijimet më të arrira artistikisht dhe të një veçansie origjinale poezitë që kanë për titull këto leksema, pa peizazhin e tyre”.<sup>(17)</sup>

Nëse perifrazojmë Kadarenë, i cili në librin “Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe” shprehet se: “...edhe Camajt do t’i shkonin për shtat ato përfundime: mekanizmat letraro-kulturore të kohës, që nga organet e shtypit të specializuar, kritika zyrtare dhe ligjëruesit universitarë të letërsisë, deri te lexuesi i zakonshëm, për nga fenomeni botëkuptimor-estetik ishin të vjetruar, të tejkaluar, të papërgatitur për

t'u asimiluar, shijuar dhe vlerësuar si duhet një materie e re letrare, kaq cilësore dhe origjinale, njëkohësisht”.

Antonio Guzzeta, i cili merret gjerësisht me poezinë e Camajt, thekson se: Mali e Vërrini e shoqërojnë poezinë e Camajt përherë, pa u artikulluar me emfazë, por si mall i heshtur e i përhershëm”.<sup>(18)</sup>

Por po t'i kthehemi fillimeve të krijimtarisë së Camajt, atëherë ai dy librat e parë poetikë “Një fyell ndër male” (1953), dhe “Kënga e Vërrinit” (1954) i boton në Prishtinë dhe në të dy këto libra figura themelore është fyelli dhe mali. Kështu që nuk kemi si të mos i lidhim këto me trashëgiminë me të hershem sidomos me Lahutën e Malcis së Gjergj Fishtës dhe me “Hijen e Maleve” të Ernest Koliqit “... dhe këto figura identifikuese tregojnë përgjithmonë Fishtën epik e Camajn lirik”<sup>(19)</sup>

*“po zani yt e ka ma të madhen vlerë,  
Pra, fyell, tingllo mes blegërimit  
të grigjave,  
të zhurmës s'pyllit, që gjimon ne erë,  
Jeton për prroje tue shungulluem  
brigjeve”.*<sup>(20)</sup>

Me një këndvështrim të veçantë e sheh veprën e Camajt, Prof. Dr. Shaban Sinani, i cili pohon se “Mbijetesja e njeriut mbi gurin e moçëm, në zgafella të humbura të natyrës alpine shqiptare, atje ku bishat dhe egërsirat janë të pranishme si gjallesat e shtëpisë, përbën thelbin e shumicës së veprave të tij.”<sup>(21)</sup>

Së pari: Camaj e njeh mirë traditën shkrimore paraardhëse të vendit tonë, e ndërgjegjshëm e rrënjës fort gjuhën e pasur të këtij vendi dhe si lëvrues i shquar, e mbi të gjitha si studiues, e tejkalon dhe pasuron atë, e ngre në nivele të reja me një forcë artistike marramendëse.

Së dyti: Camaj arrin suksesshëm ta mbajë poezinë e vet jo vetëm në shtratin e traditës, por me një paraqitje të figurshme e ngre lart si askush tjetër kumtin e domethënies.

Së treti: Vështirë të gjendet një tjetër krijues që, si Camaj, të ketë një prodhimtari dhe shkëlqim në krijimtarinë e mirëfilltë letraro-artistike, që të ketë një individualitet krijues të spikatur dhe të veçantë apo që të mitizojë dhe ndërtojë e rindertojë me një origjinalitet artistik të spikatur.

Së katërti: Edhe pse me atdhe të ndaluar e me një ndarje hermetike nga lexuesi i vendit të vet e pati privilegjin të mund të shkruante drejtpërsëdrejti në gjuhët e mëdha të kulturës evropiane, por asnjëherë jashtë gjuhës dhe pasurisë së saj të vendit prej nga vjen.

Së pesti: Në krijimtarinë letrare të Martin Camaj është dëshmuar aftësia dhe imagjinatën e krijuesit të madh, ndërkohë që kufijtë midis prozës dhe poezisë nuk janë të prerë, por shpesh ndërfiten tek njëra -tjetra e shkrihen në shumë elemente, siç dëshmojnë, pos të tjerash, veprat “Djella” (1958), “Dranja” (1981).<sup>(22)</sup>

Së gjashti: Krijimtaria e Martin Camajt nuk është krijimtari e një krijuesi të një mjedisi dhe të një kohe të caktuar e me dimensione të kufizuara gjeografike, por është një shkrimtar modern me përmasa universale.

Së shtati: Poezia e Martin Camajt shpesh është tejet e ndërlikuar edhe pse është poet, që nuk u shkëput kurrë nga rrënjët e tij të vendlindjes.

Së teti: “Ndarja e hershme e poetit nga vendlindja dhe nga atdheu dhe gjallimi larg tyre për gati një gjysmë shekulli u shndërrua në një ndjenjë dhimbjeje, që u ushqye dhe u mbajt gjallë vijimisht nga vetmia, e cila po ashtu iu bë pjesë e pandashme e qenies së tij dhe e bëri atë shpesh të vuante”.<sup>(23)</sup>

Së nënti: Vetmisë së Camajt “i bashkëngjitet pastaj dhe tema e shtegtit, me të cilën edhe motivi i dhimbjes për gjërat më të dashura që duhet doemos t'i braktisim këto elementë, do t'i jepnin veprës tonë pikëlluese, nëse nuk do të përcilleshin vijimisht nga një ironi e hollë racionale, atëherë kur ndjenjave u mungon guximi për t'i përballuar drejtpërdrejt problemet e jetës”, Shkruan Antonio Guzzeta, Poezia e Martin Camajt “në: “Jeta e re”, Prishtinë 1996.”<sup>(24)</sup>



#### Literatura:

1-Shllaku, Primo: “Një Uliks që s'mbërriti kurrë në Itakë”, Atë Gjergj Fishta, Lezhë, 2006, fq.59.

2-Camaj, Martin: “Formulë mëngjije”, “Njeriu më vete e me të tjerët”, botimet “Camaj vepra”, vëll i IV, Tiranë, 2010, fq. 75.

3-Shllaku, Primo: “Një Uliks që s'mbërriti kurrë në Itakë”, Atë Gjergj Fishta, Lezhë, 2006, fq.82.

4-Camaj, Martin: “Ai mal akulli ndan kohën”, “Njeriu më vete e me të tjerët”, vëllimi IV botimet “Camaj, vepra”, Tiranë, 2010, fq. 70.

5-Pipa, Arshi: “Poezia dhe poetika e Camajt”.

6-Hamiti, Sabri: “Martin Camaj i fillimit”, “Studime filologjike”, nr . 3-4, Tiranë, 2010, qf. 16.

7-Camaj, Martin: “Legjana,” “Vepra letrare”, vëllimi I, Tiranë, 1996, fq. 149-150.

8-Camaj, Martin: “Një fyell ndër male” në “Kanga e Vërrinit”, të pabotueme, dorshkrime, variante”, botimet “Camaj, vepra” vëllimi IX, Tiranë, 2010, fq.10-11.

9-Shllaku, Primo: “Një Uliks që s'mbërriti kurrë në Itakë”, Atë Gjergj Fishta, Lezhë, 2006, fq.96.

10-Maloki, Krist: “Letër e Martin Camajt, drejtuar Krist Malokit, 5 tetor 1953”, “Refleksione”, Faik Konica, Prishtinë, 2005, fq. 300.

11-Camaj, Martin: “Im Bir dhe unë”, “Kanga e Vërrinit”, botimet “Camaj -vepra”, vëllimi i IX, Tiranë, 2010, fq. 106.

12-Camaj, Martin: “Im birë dhe unë”, “Kanga e Vërrinit” botimet “Camaj -vepra”, vëllimi i IX, Tiranë, 2010, fq. 106.

13-Sinani, Shaban: “Camaj i paskajtur”, botimet “Naimi”, Tiranë, 2011. fq.36.

14-Shala, Kujtim: “Camaj i pa (zbuluem)”, “Prolepsa” AIKD, Prishtinë, 2011, fq. 160.

15-Shehri, Dhurata: “Liria e vetmisë ose njeriu me veten e pa të tjerë”, Studime Filologjike, nr. 1-2. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011, fq. 45.

16-Maloki, Krist: “Letër e Martin Camajt drejtuar Krist Malokit, 5 tetor 1953”, “Refleksione”, Faik Konica, Prishtinë, 2005, fq. 303.

17-Blushi, Kiço: “Në poetikën e Martin Camajt: miti i gjarpërit, metafora e hijes, kulti i lisit”, Drita, Tiranë, 1997, fq. 64.

18-Guzzeta, Antonio: “Poezia e Martin Camajt”, “Jeta e re” Prishtinë, 1996, fq. 44.

19-Hamiti, Sabri: “Martin Camaj i fillimit”: “Studime Filologjike”, nr .1-2, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Tiranë, 2010. Fq. 12.

20-Camaj, Martin: “Fyellit”, “Një fyell ndër male”, botimet “Camaj, vepra”, vëllimi i IX, Tiranë, 2010, fq.15.

21-Sinani, Shaban. “Camaj i paskajtur”, botimet Naimi, Tiranë, 2011, fq. 256.

22-Berisha, Anton Nikë: “Vepra letrare e Martin Camajt”, Tiranë, 2000, fq. 68.

23-Dancetoviq, Vojislav: “Ku qëndron origjinaliteti i Camajt?”, “Jeta e re” Prishtinë, 1996, fq.74.

24-Guzzeta, Antonio: “Poezia e Martin Camajt”, “Jeta e re”, Prishtinë, 1996, fq. 44.

(vijon në numrin e ardhshëm)

# PARADA E RRËNJËVE SHEKULLLORE NË ZEMRËN E SHQIPTARËVE

Të shtunën e kaluar, më 20 shtator 2025, për të katërtin vit radhazi, qyteti i Astit në Piemonte të Italisë, u shndërrua në një skenë të madhe sfilate të kostumeve, folklorit dhe traditave shqiptare.

Edhe këtë vit, "LE RADICI DEL CUORE - RRËNJËT E ZEMRËS", aktivitetet i organizuar nga shoqata "Assoalbania Piemonte" si dhe Qendra Artistike e Kulturore "Margarita Xhepa", me mbështetjen e Bashkisë së Astit, solli në qytet një larmi të pasur kostumesh, muzike dhe shijesh kuzhine, gjatë një dite të tërë përkushtuar kulturës, paqes dhe urave që lidhin vëllezëri mes popujve, pa dallim identiteti.

Në orën 15:30, nga sheshi "Roma", parada përshkoi qendrën e qytetit, duke kaluar nga sheshi "Alfieri" dhe sheshi "1 Maji", për t'u ndalur në parkingun "Way Assauto". Pas përshëndetjes së Kryetarit dhe Nënkrutarit të Bashkisë së Astit, si dhe të kryetarëve e këshilltarëve të tjerë bashkiakë, me origjinë shqiptare nga disa qytete të veriut, e mori fjalën edhe zyrtarja për Diasporën pranë Konsullatës së Shqipërisë në Milano, Znj. Luljeta Çobanaj, e cila në fjalimin e saj, theksoi rëndësinë e kësaj veprimtarie, jo vetëm për popullin dhe bashkësinë shqiptare, por edhe për lidhjet dhe urat, që krijohen me vëllezërit tanë italianë.

Pas fjalimeve nga autoritetet e tjera institucionale të Astit, deri në orët e vona të mbrëmjes, u zhvillua një spektakël madhështor, me prezantimin e valleve shqiptare dhe instrumenteve tradicionale karakteristike, nën shoqërimin e grupeve folklorike dhe shoqatave të shumta, që erdhën jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga bashkësi të ndryshme shqiptare, si: Torino, Modena, Brescia, Milano, Montebelluna, e të tjera. Ndër të ftuarit ishin edhe këngëtarët: Mustafa Meja, Renato Jaho dhe Dj Beni 006.

Gjatë shfaqjeve artistike, pjesëmarrësit patën mundësinë të shijojnë gatimet tradicionale shqiptare, të shoqëruara me pije verërash nga rajoni i Piemontes, duke festuar kështu takimin mes kulturave dhe popujve, pa dallim gjuhe.

"Bashkësia e jone dëshiron të ndajë me qytetin e Astit rrënjët e veta, identitetin dhe traditat që kemi ruajtur ndër shekuj, pavarësisht një historie të shënuar nga pushtimet dhe emigracioni", thanë organizatorët, të kënaqur nga pjesëmarrja e gjerë e komuniteteve të ardhura nga larg.

Ndërmjetësja kulturore, Sabina Darova shpjegoi se të gjitha veshjet në sfilatë, janë kostume popullore nga zona të ndryshme



shqiptare, disa origjinale dhe të çmuara, si "Xhubleta", një veshje artizanale prej leshi të zi, e qëndisur me motive që përfaqësojnë aspekte të ndryshme të jetës. Një veshje e përdorur kjo në Veri të Shqipërisë që daton mbi 4000 vite më parë dhe që është shpallur trashëgimi kulturore nga UNESCO.

Nga kjo veshje kemi dy ekzemplarë, të trashëguar brez pas brezi. Kurse disa kostume të tjera, janë riprodhuar në kohët moderne duke ruajtur traditat artizanale të hershme.

Manifestimi i 20 shtatorit ishte një rast feste midis miqsh, i cili bashkoi Shqipërinë dhe Piemontin, të mbështjellë me

flamurin tonë, duke kënduar së bashku himnet kombëtare.

**Nga ANGELA KOSTA,**  
gazetare shkrimtare, poete, eseiste,  
redaktore, kritike letrare, botuese,  
promovuese ndërkombëtare

## REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj  
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,  
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia  
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,  
Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,  
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSUAN BOTIMIN  
VËLLEZËRIT, ZEF,  
KRISTJAN E KLAUDIO  
PALI, ME BANIM NE  
KOMUNEN CUNEO,  
ITALI**

